

TLAS



SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË

Gazeta TLAS

Botim i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë

Nr. 2 / 2012



ROUNDTABLE ON PERSPECTIVES OF THE LEGAL AID IN ALBANIA

TRYEZË E RRUMBULLAKËT PËR PERSPEKTIVAT E NDIHMËS LIGJORE NË SHQIPËRI

Tirana, 23 May 2012
Tirana International Hotel

Botimi i këtij materiali është mbështetur financiarisht nga



MISIONI I TLAS

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) është regjistruar si organizatë jo fitimprurëse, e pavarur, me Vendimin Gjykatë Nr. 346, datë 18/12/2006, themeluar nga CAFOD UK.

TLAS ka filluar aktivitetin si program i Cafod Albania, që në vitin 1999 dhe vazhdon të ofrojë shërbim ligjor falas për kategoritë në nevojë për çështje civile.

Plotësimi i nevojave ligjore të njerëzve në nevojë, sensibilizimi i tyre mbi të drejtat themelore të njeriut, nxitja e ndryshimeve të sistemit ligjor, në funksion të përmirësimit të kushteve ekonomiko-sociale të individëve dhe grupeve vulnerabël.

OBJEKTIVAT E TLAS

- Të ofrojë shërbime të plota ligjore për shtresat në nevojë të shoqërisë;
- Të sigurojë që njerëzit në nevojë të kenë më shumë akses në sistemin ligjor;
- Të ndërmarrë inisiativa për përmirësime në legjislacion, advokim dhe lobbying për realizimin e tyre;
- Të ndikojë në përmirësimin e qeverisjes, përmes përfshirjes së grupeve vulnerabël;
- Të botojë të dhëna mbi probleme të rëndësishme ligjore dhe të të drejtave të njeriut, që janë ndeshur gjatë trajtimit të rasteve të klientëve të TLAS.

BORDI DREJTUES

Av. Vangjel Kosta
Viktor Gumi
Av. Maksim Haxhia
Suzana Sakiqi
Shkelqim Bozgo

GRUPI KËSHILLIMOR

Av. Ardjana Fullani
Dr. Tefta Zaka
Av. Dashamir Kore
Av. Natasha Sheshi
Av. Perikli Zaharia

STAFI I TLAS

Dr. Rajmonda Bozo
Migen Elmazaj
Av. Adrian Shega
Dr. Elvira Dervishi
Av. Adnan Hoxha
Av. Anisa Metalla

Konkluzione të TLAS nga tryeza e rrumbullakët “MBI PERSPEKTIVËN E NDIHMËS LIGJORE NË SHQIPËRI”

1.Reforma për kuadrin ligjor ekzistues të Komisionit të Ndi- hmës Ligjore Falas.

Me miratimin e Ligjit nr. 10039 datë 21.12.2008 “ Për ndihmën juridike ” dhe me ngritjen e “Komisionit Shtetëror për Ndi-hmën Juridike”, Komisioni është organi kryesor përgjegjës për funksionimin e të gjithë skemës së ndihmës ligjore në republikën e Shqipërisë.

Është për t'u vlerësuar miratimi nga ana e Komisionit i akteve nënligjore që bëjnë të mundur funksionimin në praktikë të ndihmës juridike.

Gjithashtu duhet vlerësuar puna e Komisionit për të kontraktuar shërbimin e ndihmës ligjore për rastet konkrete të miratuar në këtë periudhë.

Nga diskutimet e pjesëmarrësve, kryesisht aktorëve të shoqërisë civile të përfshirë në zbatimin e shërbimit të ndihmës juridike rezultuan këto probleme që lidhen me përmirësimin e punës së Komisionit;

-Mungon informacioni i nevojshëm qoftë për vetë ekzistencën e Komisionit ashtu edhe për mënyrën se si mund të kontaktojnë personat që janë përfitues të mundshëm të ndihmës juridike me Komisionin.



-Mënyra e funksionimit të deritanishëm të Komisionit, nëpërmjet kontakteve të tij drejtëpërdrejt me përfituesit e mundshëm konsiderohet joefektive.

Kontaktimi i drejtëpërdrejtë i Komisionit përfaqëson pamundësi fizike kontakti pasi aplikantët janë në vështirësi për të kontaktuar stafin e Komisionit në ambientet e tij (në Ministrinë e Drejtësisë) dhe për më tepër rritja e pritshme e këtij numri personash (me zgjerimin e informacionit për mundësinë e përfitimit të ndihmës juridike) do t'a bënte

të pamundur Komisionin të kontaktonte dhe do të vështirësonte aksesin e aplikantëve, në mënyrë të veçantë të atyre që nuk banojnë në qytetin e Tiranës.

-Sugjerohet që Komisioni të kontraktojë operatorët e caktuar në Ligj për ofrimin e ndihmës juridike (avokatë, zyra avokatie, organizata jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike) duke iu ngarkuar këtyre operatorëve të kryejnë edhe kontaktin e drejtëpërdrejtë me aplikantët. Në mënyrë të veçantë duhet të shfrytëzohen për këtë qëllim organizatat jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike të cilat kanë infrastrukturë të ngritur, staf të kualifikuar për ndihmën juridike dhe komunikimin me njërëzit në nevojë dhe mundësi bashkëfinancimi në bashkëpunim me donatorë të tjerë. Në mënyrë të veçantë, në ofrimin e ndihmës juridike parësore apo të formës “ klinik” këto organizata kanë mundësi më të mëdha se avokatët e veçantë apo zyrat e avokatisë.



2. Reforma për sistemin e tarifave ligjore.

Të gjithë diskutantët e tryezës konstatuan në mënyrë unanime se, sistemi i taksave gjyqësore në R. E Shqipërisë kufizin dukshëm aksesin e individëve me të ardhura të pakta në shërbimet gjyqësore, qoftë në depozitimin e një padie në gjykatë ashtu edhe në përballimin e shpenzimeve të mëtejshme për zhvillimin e gjykimit dhe ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

Ky fakt është konstatuar edhe nga gjykata e rrethit gjyqësor Pogradec, e cila me vendim in e ndërmjetëm datë 17.04.2012 i është drejtuar gjykatës Kushtetuese të R. Së Shqipërisë me kërkesën për, " T'i kërkojë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë kontrollin e kushtetueshmërisë së Neni 11/2 i Ligjit Nr. 10 065, datë 29.1.2009 « Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9975, datë 28.07.2008 « Për taksat kombëtare ». Në thelb kjo kërkesë përmban argumenta që lidhen me kufizimin e aksesit

të personave në pamundësi ekonomike për të përballuar "taksën gjyqësore".

-Sistemi i taksave gjyqësore duhet të rishikohet për të mos kufizuar apo penguar individët me të ardhura të pamjaftueshme për të siguruar shërbimet gjyqësore për shkak të pamundësisë për të paguar tarifat gjyqësore.

-Sistemi i taksave gjyqësore nuk mund të përcaktohet me akt nënligjor por vetëm me ligj në mënyrë që të garantojë siguri që ndryshimet (në fakt deri





tani vetëm rritje) të jenë rezultat i një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës të të gjithë aktorëve të interesuar.

-Sistemi i taksave duhet të parashikojë;

- pagesa të shkallëzuar sipas llojit të padive dhe cilësisë së subjektit;

-sipas llojeve të padive duhet që, veç padive të përjashtuara aktualisht nga tarifa gjyqësore (masat e mbrojtjes nga dhuna në familje) duhet të shtohet ky rreth i padive edhe me padi të tjera siç mund të jenë ato që lidhen me; të drejta nga marrëdhëniet e punës, kërkimi i kujdes-

tarisë, kërkimi i dëmshpërblimit që rrjedh nga trafikimi, kërkimi i dëmshpërblimit nga organet shtetërore, kërkimet që lidhen me të drejtat e pensioneve të llojeve të ndryshme, kundërshtimi i refuzimit të dhënies së ndihmës ekonomike, kërkimi i regjistrimit të fëmijëve,

-sipas subjektit që i drejtohet gjykatës duhet që të parashikohen përjashtime, pagesa të reduktuara (në %) apo pagesa të ndara në këste gjatë procesit të gjykimit për subjektet që konsiderohen " me të ardhura të pamjaftueshme" ,

Në këtë kategori, veç kategorive të konsideruara përfituese me ligje të veçanta, si viktimat e trafikimit, viktimat e dhunës në familje, invalidët, duhet të shtohen edhe të gjithë subjektet të cilët konsiderohen përfitues të ndihmës ligjore sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 10039 datë 21.12.2008 " Për ndihmën juridike ".

Këto subjekte përfituese duhet që të parashikohen si përfitues të përjashtimit apo kufizimit të tarifës jo vetëm të tarifës për de-

pozimin e padisë por edhe për shpenzimet e tjera gjyqësore siç janë, tarifat për të marrë kopje të akteve apo të vendimit gjyqësor, të tarifave të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, të pagesave për ekspertët apo pagesat e psikologëve në gjykimet familjare.

Në bazë të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë, nr. 13, datë 12.2.2009 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, ministrisë së drejtësisë, prokurorisë, Notarisë dhe Zyrës së Regjistrimit të pasurive të paluajtshme", paditësja duhet të paguajë tarifën e shërbimit për administratën gjyqësore në masën 12.000 lekë;

Në bazë të ligjit nr. 8977, datë 12.12.2002 (i ndryshuar) "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", lidhja nr.5 pika A "Taksa për veprimet dhe shërbimet që kryhen nga administrata gjyqësore", paditësja duhet të paguajë 1 % të vlerës së objektit të kërkesë- padisë, që



do të thotë 1% të shumës që viktima kërkon nga autori i veprës penale.

Në bazë të ligjit nr. 8977, datë 12.12.2002 (i ndryshuar) "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", Lidhja nr.5 pika B, "taksë për veprime që kryhen nga përmbaruesi gjyqësor", paditësja duhet të paguajë për ekzekutimin e vendimit shumën prej 3% të vlerës së vendosur nga gjykata.

Aktualisht nuk ka ligj të veçantë, akte nën-ligjore, rregullore, instruksione, apo guida të tjera,

të cilat përjashtojnë kategoritë vulnerabël nga pagesat e tarifave dhe taksave për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore si dhe për veprimet që kryhen nga përmbaruesi gjyqësor.

Në lidhje me këtë situatë, janë bërë përpjekje për ndryshime në ligjin nr. 8977, datë 12.12.2002 (i ndryshuar) "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", duke sugjeruar që viktimat e trafikimit të përjashtohen nga këto taksa, pasi është parë si një faktor që ndikon drejtpërsëdrejti në uljen e aksesit të

viktimave në sistemin e drejtësisë. Në lidhje me këtë kërkesë ka patur mbështetje nga Koordinatorja kombëtare kundër trafikimit të Qenieve Njerëzore, por deri tani nuk është bërë asnjë ndryshim.

Gjithashtu i është kërkuar Avokatit të Popullit, të llobojë ndryshimin e Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë, nr. 13, datë 12.2.2009 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, ministrisë së drejtësisë, prokurorisë, Noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të pasurive të paluajtshme" në mënyrë që të përshatet ky udhëzim me parimin e aftësisë paguese dhe të parashikohen të gjitha kategoritë shoqërore që duhet të përjashtohen nga tarifat e shërbimit të administratës gjyqësore, duke marrë parasysh të gjitha subjektet të cilat kanë probleme ekonomike, financiare e sociale.

Praktika e deritanishme të ofruesve të shërbimeve ligjore falas në procesin civil, në tregon se nuk ka pasur lehtësime



apo përjashtime nga pagesat e tarifave dhe taksave si për shërbimin e administratës gjyqësore, ashtu edhe për shërbimin përmbarimor.

Shembulli i rastit të trafikimit të qenieve njerëzore D.S, viktimë u përball me këto pagesa. Kështu D.S pagoi tarifën për shërbimin e administratës gjyqësore në masën prej 12.000 Lekë në bazë të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë, nr. 13, datë 12.2.2009 si dhe taksën prej 1% të vlerës së kërkuar si dëmshpërblim prej saj, në bazë të ligjit nr. 8977, datë 12.12.2002 (i ndryshuar) "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", Lidhja nr.5 pika A. Gjithashtu D.S është përballur edhe me taksën për veprimet që kryhen nga përmbaruesi gjyqësor në masën 3% në bazë të ligjit nr. 8977, datë 12.12.2002 (i ndryshuar) "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", Lidhja nr.5 pika B.

Zyra e Përmbarimit vazhdon të mos e marrë përsipër ekzekutimin e vendimit, sepse taksa prej 3% të vlerës duhet të



parapaguhet. D.S nuk ka aftësi paguese. Kështu, ende nuk është ekzekutuar vendimi i formës së prerë të Gjykatës, dt. 19. 02. 2010, me të cilin Gjykata ka dëmshpërblyer viktimën e trafikimit me shumën 40 000 euro. (raste të tilla të ngjashme vazhdojnë të hasen).

Edhe kur ofruesit e shërbimeve ligjore falas kërkojnë që taksa prej 3% pranë zyrës së përmbarimit të paguhet në përfundim të ekzekutimit të vendimit, në asnjë rast Zyra e Përmbarimit nuk e pranon këtë kërkesë. Gjithashtu, kësaj kërkesë nuk i është përgjigjur as Agjencia

e Administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara. Për këtë bëhet pengesë edhe parashikimi ligjor, sipas të cilit, të gjitha pasuritë e konfiskuara janë pronë e shtetit.

Duke pasur parasysh situatën e rënduar financiare e ekonomike të individëve në nevojë për asistencë të plotë ligjore, apo viktimave të trafikimit të qënieve njerëzore, si dhe situatën e tyre të rënduar psikologjike e sociale, sanksionimet ligjore në lidhje me taksat dhe tarifatat ndikojnë në uljen e aksesit të viktimave të trafikimit, në organet e drejtësisë.

Eshtë e nevojshme që të ndërhyhet për ndryshimin në ligjin nr. 8977, datë 12.12.2002 (i ndryshuar) "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë" si dhe në aktet e tjera nënligjore me qëllim që viktimat e trafikimit, ato të krimeve të dhunshme dhe kategoritë vulnerabël, të përjashtohen nga taksat dhe tarifatat në sistemin e drejtësisë. Gjithashtu, mendojmë se në të gjitha rastet, në të cilat viktimat

e krimeve paraqesin padi civile në procesin penal për të kërkuar shpërblimin e dëmit, nuk duhet t'i nënshtrohen taksave dhe tarifave të procesit civil. Për këtë është e nevojshme të amendohet Kodi i Procedurës Penale.

Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike duhet sa më shpejt të ketë faqen e tij në internet që të aksesohet nga qytetarët në nevojë. Mungesa e informacionit për publikun e gjërë për ekzistencën e këtij shërbimi ligjor falas dhe mundësitë që ofron ka cënuar dhe vazhdon të cënojë aksesin në drejtësi të grupeve në nevojë si dhe të sigurojë transparencë me të madhe në lidhje me konkurimin e subjekteve për ofrimin e shërbimit ligjor falas

Raimonda BOZO
Drejtore Ekzekutive e TLAS



TRYEZË E RRUMBULLAKËT MBI PERSPEKTIVËN E NDIHMËS LIGJORE NË SHQIPËRI

Tiranë 23 Maj, 2012

Fjalimet e Hapjes:

- Ambasadori i BE /Përfaqësues i Delegacionit të BE
- Avokati i Popullit
- Ministër i Drejtësisë
- OJF

Diskutimi i parë:

Faza e zbatimit të Ligjit për Ndihmën Juridike

- Kryetare e Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike
- Shërbimi Ligjor Falas Tiranë
- Zyra e Avokatit të Popullit
- Euralius
- Dhoma Kombëtare e Avokatisë
- OJF të Ndihmës Juridike

Diskutimi i dytë:

Taksat/Tarifat Gjyqësore dhe Ndihma Juridike

- Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike
- Euralius
- Ministria e Drejtësisë
- Avokati i Popullit
- Shërbimi Ligjor Falas Tiranë
- Dhoma Kombëtare e Avokatisë
- OJF të Ndihmës Juridike

INFORMACION

SEMINAR TRAJNIMI ME PUNONJËSIT SOCIALË TË PROJEKTIT SOS «FUQIZIMI I FAMILJES»

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) organizoi një seminar trajnimi me punonjësit socialë të Projektit SOS «Fuqizimi i familjes». Ky seminar u organizua në mjediset e Fshatit SOS në datat 5, 6 qershor 2012. Në këtë aktivitet morrën pjesë pjesëtarë të pu-

nonjësve socialë të Projektit SOS «Fuqizimi i familjes» nga qendrat Sauk, Don Bosko, të Tiranës si edhe të Shkodrës.

Fjala e hapjes, prezantimi i aktivitetit të Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS) dhe qëllimi i seminarit të trajnimit u mbajt nga Elvira Dervishi, Këshilltare e TLAS. Pjesëmarrësit u njohën me aspekte të ndryshme të aktivitetit të TLAS, për të gjetur sa më shumë pika të përbashkëta, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ekzistues ndërmjet TLAS dhe Projektit SOS «Fuqizimi i familjes». Në këtë fjalë u vu në dukje që qëllimi i TLAS është plotësimi i nevojave ligjore të njerëzve në nevojë, sensibilizimi i tyre mbi të drejtat themelore të njeriut, nxitja e ndryshimeve ligjore në funksion të përmirësimit të kushteve ekonomike-shoqërore të grupeve në nevojë, për një integrim më të mirë të tyre në shoqëri. Grupet e synuara që mund të përfitojnë shërbimin ligjor falas janë individë të papunë, ose kur ndihma ekonomike apo pensioni



është burimi i vetëm i jetesës, familje me të ardhura nën minimumin e jetesës, jetimë, persona me aftësi të kufizuara, të mitur, të paraburgosur dhe të burgosur vulnerabël, minoritete të diskrimiuara.

Tema e parë e seminarit kishte të bënte me aspektet ligjore dhe institucionale të procesit të kujdestarisë dhe birësimit të fëmijëve. Tema u mbajt nga Anisa Metalla, avokate e TLAS. Në këtë temë u sqaruan aspekte të ndryshme të kushteve për të qënë kujdestar, rastet e vendosjes së të miturit në kujdestari, procedura e vendosjes në kujdestari, funksionet e kujdestarit të të miturve, mbarimi i kujdestarisë së të miturit, përfundimi i funksioneve të kujdestarit. Gjithashtu në temë u trajtuan aspektet teorike të birësimit, tiparet daluese të birësimit, kushtet për të birësuar, gjykata kompetente për shqyrtimin e birësimit, si dhe pasojat e birësimit. Gjatë shtjellimit të temës u paraqitën edhe shumë raste praktike të aspekteve të ndryshme të ushtrimit

të kujdestarisë, kryesisht për të miturit.

Në seminar u trajtua gjerësisht problemi i kujdestarisë edhe në këndvështrimin e psikologut, roli i psikologut në këto procese dhe detyrimet ligjore që rrjedhin, sipas llojit të rastit. Kjo u realizua nëpërmjet temës «Psikologu dhe Kujdestaria», mbajtur nga Naureda Hasani, psikologe.

Në këtë temë u trajtuan probleme të lidhura me standartet e vlerësuesit dhe vlerësimit, plotësimi i raportit të vlerësimit, parimet e etikës, roli i psikologut në çështje ku do të bëhet





vlerësimi i rrezikut prindëror, mënyra si kryhet një vlerësim i kërkuar nga gjykata në çështjet e kujdestarisë, marrja në pyetje e fëmijës në një proces kujdestarie, roli i psikologut në kujdestarinë jashtë procesit gjyqësor, kërkuesit e kujdestarisë, etj. Materiali u shoqërua me ilustrime të shumta nga rastet e ndeshura në praktikë.

Tema e fundit e realizuar ditën e parë të seminarit, kishte të bënte me problemet e ndryshme të abuzimit të fëmijëve. Kjo temë u mbajt nga Sabina Tahsini, punonjëse sociale në ARSIS.

Në këtë temë u trajtuan aspekte të llojeve të ndryshme të abuzimit me fëmijët, duke u përqëndruar në abuzimin fizik, emocional, seksual, neglizhimin dhe trajtimin neglizhent, si dhe shfrytëzimin seksual dhe tregtar. Gjatë temës u dhanë shumë shifra dhe fakte të abuzimit të shpalura nga Save the Children, UNICEF, duke u përqëndruar kryesisht në format më të përhapura të abuzimit psikologjik në shtëpi dhe në shkollë. U trajtuan aspekte të abuzimit të fëmijëve në shoqëri, pasojat e abuzimit tek fëmijët, mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi në legjislacionin dhe politikat ekzistuese, indikatorët e abuzimit të fëmijëve, në të gjitha llojet, në abuzimin fizik, abuzimin seksual, në abuzimin psikologjik/emocional. Gjatë temës u trajtuan edhe shumë raste nga praktika.

Në ditën e dytë të seminarit u shtjelluan tre tema të tjera. Tema e parë kishte të bënte me rritjen në regjistrimet e fëmijëve dhe regjistrimet e tjera civile, të ndjekura me rrugë adminitra-

tive dhe gjyqësore. Kjo temë u mbajt nga Elvira Dervishi, këshilltare e TLAS.

Në këtë temë u trajtuan kryesisht mënyrat e regjistrimit të fëmijëve të paregjistruar, që ju përkasin tre grupeve kryesore të fëmijëve që nuk mund të regjistroheshin, duke u bazuar në legjislacionin e mëparshëm: 1. për shkak se nuk gjendet personi që mund t'i regjistrojë ata ligjërisht; 2. kanë lindur jashtë shtetit dhe nuk kanë dokumentacionin e kërkuar; 3. kanë lindur në kushte spitalore, por nënat kanë raportuar të dhëna të pasakta. Në sajë të hartimit të udhëzimeve dhe marrëveshjeve të posaçme me ministritë përkatëse, është përcaktuar mënyra e regjistrimit të fëmijëve edhe në këto raste.

Tema për parandalimin dhe adresimin e rasteve të dhunës në familje/institucion, u mbajt nga Zini Kore, ekspert në ARSIS. Tema u shoqërua me një numur të madh rastesh të hasura në praktikën e ARSIS.

Legjislacioni i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Shoqërore, si dhe ai i Strehimit, u trajtuan nga Adnan Hoxha dhe Adrian Shega, avokatë në TLAS. Në temat e zhvilluara u bënë sqarime mbi ndryshimet në legjislacion për ndihmën ekonomike. U sqaruan se cilat janë grupet që përfitojnë ndihmë ekonomike, u sqarua se cilat janë shërbimet shoqërore që ofrohen nga shteti, si mund të përfitohet ndihma ekonomike, kur ajo është e plotë dhe kur është e pjesshme, si bëhet kërkesa për përfitimin e ndihmës eko-



nomike, cilat janë përgjegjësitë dhe kompetencat e organeve shtetërore, cilat janë risitë në ligjin e ndryshuar për ndihmën ekonomike, si përfitojnë familjet që janë në procesin e zgjidhjes së martesës, etj.

Në temën kushtuar legjislacionit të Strehimit, u sqaruan aspekte që kanë lidhje me llojet dhe klasifikimin e programeve sociale të strehimit, kriteret që duhet të plotësohen për t'u klasifikuar për t'u trajtuar me programet sociale të strehimit, kriteret e përzgjedhjes së përfituesve, si mund të aplikohet për t'u traj-

tuar me strehim, në bazë të ligjit, dokumentat shoqëruese për aplikim për banesë sociale, për bonus qiraje dhe për kredi të lehtësuara.

Mbas përfundimt të paraqitjes së temave, në të dy ditët e seminarit, pati pyetje dhe diskutime të shumta, të lidhura me rastet konkrete të hasura në komunitetet ku veprojnë projektet. E gjithë tematika e diskutuar ishte e lidhur ngushtë me problemet e përditëshme që hasen në komunitete dhe për këtë arsye pati një interesim të lartë nga ana e pjesëmarrësve.



ELVIRA DERVISHI
Këshilltare Programi, TLAS

Histori e Vërtetë

M.Ç. është një djalë 15 vjeç, që nuk është i regjistruar në gjendjen civile. Ai jeton me gjyshërit e tij nga nëna dhe sapo përfundoi klasën e fundit të shkollës 9-vjeçare. Gjatë gjithë viteve të shkollës, ai nuk mundi të sigurojë një dokument identifikimi, por për të marrë dëftesën e lirim, i duhet patjetër një certifikatë lindjeje. M. ka mbetur i paregjistruar në gjendjen civile, për shkak se nëna e tij e ka braktisur atë, që kur ishte disa muajsh dhe është larguar jashtë shtetit. Sipas gjyshërve, edhe M. ka lindur jashtë shtetit, por ata nuk kanë asnjë lloj dokumentacioni për ta vërtetuar këtë fakt.

Për të realizuar regjistrimin në gjendjen civile të fëmijëve të paregjistruar, që nuk kanë nënën të pranishme, me propozim të TLAS, është hartuar një Udhëzim i Ministrit të Brendshëm, Nr. 7, datë 10.01.2012, "Për miratimin e procedurës dhe të proces-verbaleve, që do të

plotësohen nga përfaqësues të policisë së shtetit dhe të bashkive/njërive bashkiake/komunave, për rastet e fëmijëve të gjetur dhe të fëmijëve të paregjistruar në gjendjen civile". Duke u bazuar në këtë Udhëzim, TLAS filloi procedurat administrative për regjistrimin e fëmijës. Për këtë, u realizuan fillimisht një sërë takimesh me familjarët e M., me zyrën e gjendjes civile të zonës ku jeton M., me punonjës të rendit të zonës dhe u morrën vërtetime nga shkolla për ecurinë e regjistrimit të tij në shkollë.





Problemi kryesor për t'u zgjidhur, ishte përcaktimi i disa të dhënave të nevojshme për mbajtjen e aktit të lindjes, si moshë dhe gjinia e fëmijës. Në bazë të ligjit Nr. 10.129, datë 11.05.2009, "Për Gjendjen Civile", këto të dhëna përcaktohen nga mjeku i zonës. TLAS u detyrua të bënte shumë takime me mjekun pediatër të zonës dhe drejtorin e qendrës shëndetësore, deri sa ata u ndërgjegjësuan për kryerjen e këtij shërbimi. Në fakt, kjo është një procedurë e re dhe për këtë arsye do të duhet të realizohen trajnime dhe mbase

edhe hartimi i disa udhëzimeve plotësuese për sistemin shëndetësor, që mjekët të jenë më bashkëpunues në rastet të tilla. Megjithatë, u arrit të merret edhe një raport mjekësor, i nevojshëm për mbajtjen e aktit të lindjes. Duke patur një dokumentacion të plotë, mbas mbajtjes së një procesverbali të nënshkruar nga punonjësi i rendit, punonjësi social i njësisë bashkiake dhe gjyshja e fëmijës, punonjësja e gjendjes civile mbajti aktin e lindjes së fëmijës. Fëmija u regjistrua me nënë dhe baba të panjohur, por më në fund mundi të pajiset me një certifikatë personale, gjë që do t'i lejojë në të ardhmen që të ketë edhe dokumenta të tjera identifikimi si letërnjoftim apo pasaportë.

Mbas regjistrimit të fëmijës, TLAS ka filluar procedurat gjyqësore të marrjes së kujdestarisë nga gjyshja e tij. Në këtë mënyrë, ky do të jetë një fëmijë nën kujdes të një kujdestari, që do të luajë rolin e prindit për të. Në të ardhmen, nëse nëna e M. do të

vijë në Shqipëri, mund të bëhet edhe njohja e amësisë së djalit.

Gjatë gjithë këtij procesi, M. ka qënë shumë i interesuar dhe shumë bashkëpunues, për t'u paraqitur pranë organeve përkatëse, për të grumbulluar dokumenta, etj. Ai tashmë është shumë i lumtur që ka më në fund një dokument identifikues, që mund të marrë dëftesën e lirim të shkollës 9-vjeçare dhe që mund të vazhdojë normalisht jetën e tij, pranë gjyshërve që e kanë rritur.

ELVIRA DERVISHI
Këshilltare Programi, TLAS

GJYKIMI I MOSMARRËVESHJEVE ADMINISTRATIVE

Zgjidhja nga gjykata të mosmarrëveshjeve administrative është një ndër proceset më të rëndësishme përsa i përket interesave të shtetasve dhe të vetë shtetit. Duhet patur parasysh se një akt administrativ mund ti drejtohet disa personave të caktuar por gjithashtu mund ti drejtohet edhe një grupi më të gjerë personash. Prandaj mund të themi se nga një akt administrativ preken interesa të një



grupi të madh njerëzish, interesa këto që do të çenoheshin nga një akt i padrejtë i nxjerrë nga organet kompetente.

Padia për gjykimin e akteve administrative sipas nenit 324 të Kodit të Proçedurës Civile është në kompetencë të seksioneve për gjykimet administrative. Këto seksione gjykojnë:

- a) Paditë me të cilat kërkohet shfuqizimi ose ndryshimi i një akti administrativ;
- b) Padia me të cilën kundërshtohet refuzimi i miratimit të një akti administrativ ose që lihet pa u shqyrtuar në afatin e caktuar,

kundërshtimi i shtetasit në organin kompetent administrativ. Megjithatë për paraqitjen e një padie për kundërshtimin e një akti administrativ duhet të respektohen disa afate ligjore, të cilat marrin një rëndësi mjaft të madhe pasi mosrespektimi i këtyre afateve i heq të drejtën çdo qytetari për tu ankuar ndaj një akti administrativ. Kështu sipas nenit 328 të Kodit të Proçedurës Civile:

Afati për paraqitjen e padisë ndaj një akti administrative është tridhjetë ditë nga dita e shpalljes ose e njoftimit të vendimit të organit më të lartë administrativ, që ka shqyrtuar ankesën në rrugë administrative, përveç kur ligji parashikon ankimin e drejtpërdrejtë në gjykatë. Në këtë rast afati fillon nga dita e shpalljes ose e njoftimit të aktit administrativ ndaj të cilit është paraqitur padia. Kur organi administrativ më i lartë nuk ka shqyrtuar ankimin në afatin e caktuar me ligj ose kur organi kompetent administrativ nuk ka shqyrtuar kërkesën e shtetasit në afatin e



caktuar me ligj dhe kundër aktit të tij parashikohet ankimi i drejt-përdrejtë në gjykatë, shtetasi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës brenda afatit të caktuar në paragrafin e parë të këtij neni edhe pse nuk i është dhënë përgjigje për kërkesën ose ankesën e parashtruar.

Megjithatë që të kundërshtohet një akt administrative personi që e kërkon këtë gjë duhet të vërtetojë paligjshmërinë e aktit dhe dëmin që i shkaktohet nga ky akt që ai kundërshton. Sipas nenit 325 të Kodit të Proçedurës Civile: Padia mund të ngrihet kur paditësi argumenton se akti administrativ është i paligjshëm dhe se atij i cënohen interesat dhe të drejtat e tij në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi, individualisht ose në mënyrë kolektive.

Padisë, për gjykimin e një akti administrativ, i bashkëlidhet një kopje e aktit administrativ që kundërshtohet dhe çdo dokument tjetër provues.

Kërkimi i shpërblimit të dëmit të shkaktuar nga akti admin-

istrativ i kundërligjshëm mund të kërkohej sipas rregullave të përgjithshme edhe me padi të veçantë."Paragrafi i fundit i nenit të mësipërm parashikon edhe mundësinë e shpërblimit të dëmit që mund ti jetë shkaktuar një individ nga një akt administrativ, por kjo lloj padie duhet të ngrihet sipas dispozitave të shpërblimit të dëmit të parashikuara nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.

Padia e paraqitur për kundërshtimin e aktit administrativ shqyrtohet nga seksioni përkatës i gjykatës, në zonën e së cilës ka qendrën organi ad-



ministrativ, ndaj të cilit drejtohet padia. Kur padia paraqitet në gjykatën, në territorin e së cilës ka qendrën organi

administrativ, kjo ia dërgon jo më vonë se tri ditë gjykatës ku është krijuar seksioni për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Shqyrtimi i mosmarrëveshjes duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit në gjykatë.

Gjykata pasi shqyrton çështjen dhe bën vlerësimin e të gjithë provave të paraqitura vendos :

- rrëzimin e padisë kur akti administrativ gjendet i drejtë e i bazuar;

- konstatimin e pavlefshmërisë së aktit administrativ;

- anulimin pjesërisht ose tërësisht të aktit administrativ.

Vendimi i gjykatës mund të kundërshtohet në Gjykatën e Apelit dhe do të gjykohet nga seksionet administrative pranë kësaj gjykate.

Megjithatë egzistojnë disa akte Administrative të cilat nuk mund të kundërshtohen me anë të

ngritjes së padisë në gjykatë si:

a) aktet administrative të Këshillit të Ministrave dhe të institucioneve të tjera të administratës publike të nivelit qendror ose vendor që kanë karakter normativ, përveç kur ato çenojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe interesa të tjerë të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë;

b) aktet administrative që kanë rregullim ligjor të posaçëm dhe lidhen me emërimin dhe shkarkimin e funksionarëve publikë;

c) aktet administrative të cilat sipas Kushtetutës janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese."

Vlen të themi se bazuar në statistikën e gjykatave shqiptare një numër i madh aktesh që nxirren nga organet përkatëse shtetërore çenojnë interesat e një numri të madh njerëzish dhe njëkohësisht shkelin ligjet e shtetit Shqiptar.

ADRIAN SHEGA
Avokat, TLAS

REGJISTRIMI I ORGANIZATAVE JO FITIMPRURËSE, AKTET DHE ORGANET DREJTUESE

Disa nga format më të rëndësishme të organizimit ose bashkimit që janë parashikuar në Kodin Civil Shqipëtar dhe që rregullohet edhe me ligj të veçantë janë “Organizatat jo Fitimprurëse ose OJF”.

Me termin “Organizata jofitimprurëse” kuptohet shoqatat, fondacionet dhe qendrat, veprimtaria e të cilave zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe pa u ndikuar nga shteti.

Çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, ka të drejtë të themelojë një organizatë jofitimprurëse, të jetë anëtar i saj ose të marrë pjesë në organet drejtuese ose në personelin administrativ të organizatës jofitimprurëse.

Në varësi të mënyrës së organizimit, organizatat jofitimprurëse ndahen në:

1. organizata jofitimprurëse me anëtarësi:

Organizata jofitimprurëse me anëtarësi janë shoqatat.

Organizatat jofitimprurëse me anëtarësi themelohen me vullnetin e lirë të personave fizikë ose juridikë. Numri minimal i anëtarëve themelues është 5 persona fizikë ose të paktën dy persona juridikë.

Organi më i lartë drejtues i organizatës jofitimprurëse me anëtarësi është mbledhja e



përgjithshme ose asambleja e të gjithë anëtarëve të saj. Organet e tjera drejtuese zgjidhen dhe përgjigjen përpara këtij organi më të lartë

2. organizata jofitimprurëse pa anëtarësi:

Organizata jofitimprurëse pa anëtarësi janë fondacionet dhe qendrat.

Organizatat jofitimprurëse pa anëtarësi krijohen nga një a më shumë persona ose me akt testamentar.

Organi më i lartë drejtues i organizatave jofitimprurëse pa anëtarësi është bordi i drejtorëve;

Në varësi të vendit të regjistrimit të tyre, organizatat jofitimprurëse ndahen në:

1. organizata jofitimprurëse vendase:

Organizatat jofitimprurëse vendase janë ato që janë themeluar, njohur dhe regjistruar si të tilla sipas ligjit shqiptar.

2. organizata jofitimprurëse të huaja:

Organizatat jofitimprurëse të huaja janë ato organizata të themeluara, të njohura dhe regjistruara si të tilla sipas ligjit të një shteti tjetër.

Organizatat jofitimprurëse, fitojnë personalitetin juridik pasi të jenë themeluar dhe regjistruar në gjykatë, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Të njëjtave procedura të regjistrimit u nënshtrohen edhe degët e organizatave jofitimprurëse të huaja. Themeluesit e organizatës jofitimprurëse mbledhen dhe miratojnë aktin e themelimit dhe statutin e saj, si dhe mund të autorizojnë një a më shumë persona për të kryer veprimet për regjistrim.



Akti i themelimit është akti me të cilin themeluesit e saj shprehin vullnetin e tyre për themelimin e organizatës jofitimprurëse.

Fondacioni mund të themelohet edhe nëpërmjet aktit testamentar. Në këtë rast, testamenti përbën aktin e themelimit të fondacionit.

Akti i themelimit hartohet me shkrim dhe përmban në mënyrë të përmblëdhur : llojin, emrin, selinë, identitetin e themeluesve, qëllimet dhe fushën e veprimtarisë, kohëzgjatjen, emrin e personit që autorizohet të ndjekë procedurat e nevojshme për regjistrimin e organizatës jofitimprurëse dhe për përfaqësimin ligjor të saj me të tretët.

Në rastin e fondacionit, akti i themelimit duhet të tregojë natyrën, burimin dhe vlerën e pasurisë së nevojshme për realizimin e qëllimit dhe fushës së veprimtarisë të fondacionit.

Vendimet për ndryshime në aktin e themelimit, që kanë lidhje me emrin, simbolin, objektin, qëllimet, fushën e veprimtarisë së organizatave jofitimprurëse, si dhe vendimet për transformimin



e saj në një formë tjetër të një organizate jofitimprurëse, duhet t'i paraqiten gjykatës brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij vendimi. Ndryshimet në aktin e themelimit i nënshtrohen të njëjtës procedurë si në rastin e regjistrimit fillestar të organizatës.

Rregullimi i hollësishëm i çështjeve të organizimit, të funksionimit dhe të veprimtarisë së organizatës jofitimprurëse paraqitet në statutin e saj.

Statuti i organizatës jofitimprurëse hartohet nga themel-



uesit dhe miratohet në mbledhjen themeluese të organizatës. Në rastin e themelimit të fondacionit me testament, statuti mund të hartohet dhe të miratohet nga ekzekutori i testamentit, përveç rasteve kur testamenti e përcakton ndryshe.

Statuti i organizatës jofitimprurëse duhet të përmbajë:

- a) formën e organizimit;
- b) emrin, siglën dhe simbolin e veçantë të organizatës;
- c) themeluesit;
- ç) qëllimin dhe fushën e veprimtarisë së organizatës;
- d) ndalimin e shpërndarjes së fitimeve;

dh) kohëzgjatjen;

e) organet drejtuese dhe kompetencat e tyre;

ë) përbërjen e organeve të para drejtuese, që parashikohen në statut;

h) procedurat dhe mënyrat për zgjedhjen ose ndryshimin e organeve drejtuese;

i) rregulla për mbajtjen e mbledhjes, pjesëmarrjen, mënyrën dhe procedurën e votimit për marrjen e vendimeve;

j) kriteret e administrimit të pasurisë;

k) mënyrën e miratimit të ndryshimit të statutit, të aktit të themelimit dhe të rregullave të brendshme;

l) rregullat për bashkimin dhe ndarjen e organizatës jofitimprurëse;

ll) mënyrën e përfaqësimit ligjor;

m) rregullat për likuidimin dhe destinimin e pasurisë pas mbarimit të organizatës.

Përveç sa përmendet me sipër, për shoqatën, statuti duhet të parashikojë edhe:

a) rregullat për pranimin e përjashtimit të anëtarëve;

b) të drejtat dhe detyrimet e

anëtarëve;

c) rregullat lidhur me kuotizacionet.

Përveç sa përmendet me sipër, për fondacionin dhe qendrat, statuti duhet të parashikojë edhe burimet financiare dhe materiale të siguruara nga themeluesi dhe mënyrën e përdorimit të tyre.

Organi më i lartë vendimmarrës i organizatës jofitimprurëse pa anëtarësi është bordi i drejtorëve, i cili mund të marrë emërtime të ndryshme, ndërsa për ato me anëtarësi është mbledhja e përgjithshme e anëtarëve të saj.

Në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligj ose në aktet e saj, organi më i lartë vendimmarrës i organizatës jofitimprurëse mbledhet jo më pak se numri i mbledhjeve të parashikuara në statut, si dhe brenda kohës së caktuar për zhvillimin e tyre, por në çdo rast jo më pak se 1 herë në vit.

Organizata jofitimprurëse ka një organ të lartë ekzekutiv individual ose kolegjal, i cili sipas rastit



mund të quhet drejtor ekzekutiv, president, këshill ekzekutiv etj.

Veprimtaria e përditshme dhe ekzekutimi i programeve të vendosura nga organi më i lartë vendimmarrës i organizatës jofitimprurëse bëhet nga organi më i lartë ekzekutiv.

Organi më i lartë vendimmarrës i organizatës jofitimprurëse pa anëtarësi nuk mund të ketë më pak se tre anëtarë, përveç rasteve kur statuti parashikon ndryshe. Organi më i lartë vendimmarrës mbledhet me pjesëmarrjen e më shumë se gjysmës së anëtarëve të tij dhe vendos me shumicë të anëtarëve të pranishëm.

Organi më i lartë vendimmarrës i organizatës jofitimprurëse me anëtarësi nuk mund të ketë më pak se pesë anëtarë, përveç rasteve kur statuti parashikon ndryshe. Organi më i lartë vendimmarrës mbledhet me pjesëmarrjen e më shumë se gjysmës së anëtarëve të tij dhe vendos me shumicën e anëtarëve të pranishëm.

Procedurat për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse në gjykatë dhe për depozitimin e akteve të tyre në Regjistrin

përkatës rregullohen me ligj të veçantë.

Organizata jofitimprurëse njihet si person juridik ditën që vendimi i gjykatës për regjistrimin e saj ka marrë formë të prerë.

Organizata jofitimprurëse, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Personaliteti juridik i organizatës jofitimprurëse mbaron në ditën kur vendimi i gjykatës për çregjistrimin e saj merr formë të prerë.

Organizatat jofitimprurëse themelohen me ose pa afat.

Kohëzgjatja e veprimtarisë së organizatës jofitimprurëse dhe rregullat për ndryshimin e saj caktohen në statutin e saj.



ADRIAN SHEGA
Avokat, TLAS

TRASHËGIMIA RRETHI I TRASHËGIM- TARËVE LIGJORË TË DREJTAT E TRASHËGUESHME SI PASOJË E VDEKJES

Trashëgimia është kalimi me ligj ose me testament i pasurisë trashëgimore të personit të vdekur, një ose më shumë personave (trashëgimtarë). Pasuria trashëgimore është tërësia e marrëdhënieve juridike, të mirat materiale, të drejtat reale, që si pasoje e vdekjes së personit u transmetohen trashëgimtarëve të tij.

Sipas përkufizimi të mësipërm i cili gjen vend në Nenin 316 i Kodit Civil, kuptohet që trashëgimia është dy llojesh: ligjore ose testamentare. Sipas Nenin 317 të Kodit Civil, kur trashëgimlënësi nuk ka bërë testament, ka bërë por është i pavlefshëm, apo ka bërë vetëm për një pjesë të pasurisë së tij, do të zbatohet trashëgimia ligjore. Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë parashikohet në nenin 348

të Kodit Civil, sipas të cilit “Cilësia si trashëgimtar dhe pjesët takuese në trashëgim caktohen në dëshminë e trashëgimisë, të lëshuar nga gjykata, sipas rregullave të caktuara në Kodin e Proçedurës Civile”.

Si kërkues për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë mund të jetë cilido nga trashëgimtarët ligjorë të përcaktuar me ligj apo testamentarë të caktuar si të tillë nëpërmjet testamentit.



Me dëshminë e trashëgimisë, pasi konstatohet vdekja e trashëgimlënësit dhe çelja e trashëgimisë, vërtetohet rrethi i trashëgimtarëve ligjorë të asaj radhe që thirret në trashëgim në rastin e trashëgimisë ligjore, ose trashëgimtarëve të cilëve me testament u është lënë pasuria trashëgimore si dhe pjesa takuese e secilit në këtë pasuri. Dëshmia e trashëgimisë lëshohet nga Gjykata nëpërmjet një gjykimi pa palë kundërshtare mbi bazën e dokumentave të lëshuara në përgjithësi nga zyra e gjendjes civile ku përcaktohet rrethi i trashëgimtarëve ligjorë në

rastin kur trashëgimlënësi nuk ka disponuar me testament. Në rastin e dëshmisë së trashëgimisë, ligji nuk parashikon konflikt me palë kundërshtare dhe as ngritje të ndonjë padie.

Dëshmia e trashëgimisë, si një nga aktet në të cilin pasqyrohen lindja, ndryshimi a shuarja e të drejtave personale e pasurore, nuk parashikohet nga ligji si një gjykim që duhet të zhvillohet me palë kundërshtare (me padi). Po kështu, ligji nuk parashikon ndonjë rrugë tjetër, jashtë asaj gjyqësore, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë. Për rrjedhojë, ky lloj kërkimi gjyqësor me natyrë njohëse, mund të bëhet vetëm në formën e gjykimit pa palë kundërshtare, me anë të gjykimit të posaçëm të vërtetimit gjyqësor të faktit që parashikohet nga Neni 388 i Kodit të Procedurës Civile. Sipas nenit 388 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë është gjykata e vendbanimit të kërkuesit. Sipas ligjit, konkretisht Neneve 360 e vijues të Kodit Civil, përcaktohen si trashëgimtarë ligjorë përkatësisht



rrethi i personave të mëposhtëm dhe sipas mënyrë së përcaktuar më poshtë:

Trashëgimtarët ligjorë janë fëmijët, fëmijët e fëmijëve, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit e motrat dhe fëmijët e vëllezërve e të motrave të paravdekur, gjyshi e gjyshja e të paralindurit e tjerë, personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit, të afërmit e tjerë deri në shkallën e gjashtë, si dhe shteti. Këta thirren në trashëgim sipas radhës të caktuar më poshtë. Në radhë të parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta. Kur një nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit, është bërë i padenjë për të trashëguar, ka hequr dorë nga trashëgimi, ose është i përjashtuar nga trashëgimi, në vend të tij hyjnë me zëvendësim fëmijët e tij dhe kur për shkaqet e sipërme nuk mund të jenë trashëgimtarë, vijnë në trashëgim të paslindurit e tyre pa kufizim. Në këtë rast, pjesa e prindit që nuk trashëgon, ndahet ndërmjet të paslindurve në pjesë të barabarta.

Kur përveç bashkëshortit, nuk ka trashëgimtarë të tjerë, të radhës së parë, në trashëgimi thirren ata të radhës së dytë, prindërit e trashëgimlënësit dhe personat e paaftë për punë, të cilët të paktën 1 vit para vdekjes së trashëgimlënësit, bashkëjetonin me atë si anëtarë të familjes dhe në ngarkim të tij dhe kur nuk ka të tillë, thirren trashëgimtarët e radhës tjetër pasardhëse, personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit, kur nuk ka trashëgimtarë të tjerë të radhës së dytë, gjyshi e gjyshja, vëllezërit e motrat, si dhe fëmijët e





vëllezërve e të motrave të para-vdekur. Të sipërmit trashëgojnë në pjesë të barabarta, pa u bërë dallimi ndërmjet vëllezërve e motrave të një ati ose vetëm të një nëne, ndërmjet gjyshit e gjyshes nga ana e babës ose e nënës . Në çdo rast bashkëshorti merr 1/2 pjesë të trashëgimit. Kur nuk ka trashëgimtarë të radhëve të sipërme, trashëgimi i mbetet bashkëshortit pasjetues. Kur trashëgimlënësi nuk ka lënë të paslindur, as prindër ose të paralindur të tjerë, as vëllezër ose motra, apo të paslindur të këtyre, pasuria e trashëgimlënësit u kalon të afërmeve më të afërt të tij, pa bërë dal-

lim ndërmjet vijës atërore dhe asaj amësore, por gjithsesi jo më tej se shkalla e gjashtë. Kur trashëgimlënësi nuk ka lënë trashëgimtarë deri në shkallën e gjashtë, thirret në trashëgim shteti.

Me vdekjen e personit disa të drejta dhe detyrime të tij shuhën, disa të drejta dhe detyrime të tjera iu kalojnë trashëgimtarëve të tij. Ekziston parimi i përgjithshëm sipas të cilit janë të trashëgueshme dhe mund të kalojnë tek trashëgimtarët ato të drejta që nuk kanë karakter ngushtësisht vetjak personal me cilësitë e trashëgimlënësit, por që kanë karkater pasuror. Si pasojë e vdekjes shuhën të drejtat dhe detyrimet jopasurore. Shuhën gjithashtu të drejtat e personalitetit, të cilat edhe ato janë të lidhura ngushtësisht me personin që i gëzon ato. Të drejtat pasurore të të vdekurit, ose pronësia dhe të drejtat reale të gëzimit apo garancitë reale, si rregulli përgjithshëm, iu kalojnë trashëgimtarëve të të vdekurit. Po ashtu janë të trashëgueshme edhe barrët apo garancitë reale që janë vendosur mbi pasurinë trashëgimore me

vullnetin e trashëgimlënësit në kohën që ai ka qenë gjallë. Vdekja e pronarit të një pasurie e rënduar nga të drejta reale (hipoteka, pengu), do të passjelle që kjo pasuri tu kalojë trashëgimtarëve duke vazhduar e rënduar me të drejtën reale siç është pengu apo hipoteka.

Kalimi i pasurisë bëhet sipas parimit të suksedimit universal të të drejtave që rrjedhin nga trashëgimia ligjore, konkretisht Neni 332 i Kodit Civil sipas të cilit *“Trashëgimtari mund të fitojë të gjithë pasurinë e trashëgimlënësit ose një pjesë të saj, ose vetëm një send të caktuar apo një të drejtë tjetër pasurore”*. Këtë qëndrim mbajnë edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Vendimin nr 6 datë 24.01.2007 ku citojnë shprehimisht midis të tjerash se *“... pasuria e trashëgimlënësit nuk përfshin vetëm të drejtën e pronësisë mbi sende të caktuara pronë tij, por edhe tërësinë e të drejtave reale e detyrimeve që zotëronte apo mbante ai në gjallërinë e tij”*. Po ashtu në rrethin e pasurisë trashëgimore hyn jo vetëm pas-

uria që trashëgimlënësi gëzonte në gjallërinë e tij, por edhe cdo pasuri tjetër e ardhshme edhe pas vdekjes së tij, që i shtohet pasurisë trashëgimore.

Në këtë kuptim trashëgimia përbëhet nga tërësia e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të momentit dhe të ardhshme, tërë aktivet dhe pasivet e trashëgimlënësit të përshtatshme për tu trashëguar.

Adnan Hoxha
Avokat, TLAS



Histori e Vërtetë

Në zyrën e TLAS u paraqit klientja I.L. e cila paraqiste si problem ndërprerjen e marrëdhënies së punës në mënyrë të paligjshme dhe pa shkak të arsyeshëm. Pasi u diskutua çështja nga këshilltari i projektit dhe nga avokatët e zyrës u mendua se largimi nga detyra i klientes ishte bërë në mënyrë të padrejtë duke mos respektuar afatet ligjore shkaqet dhe rregullat e parashikuara nga Kodi i Punës në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.



Marrëdhënia juridike e punës është marrëdhënia që krijohet midis punëdhënësit dhe punëmarrësit në të cilën parashikohet që punëmarrësi merr përsipër të kryejë punën në shpërblym të pagës që i jepet nga punëdhënësi. Marrëdhënia e punës vërtetohet nëpërmjet kontratës së punës dhe në mungesë të saj nëpërmjet librezës së punës.

Siç rezultonte edhe nga Libreza e Punës, klientja I.L. kishte filluar punë pranë Autoritetit Shëndetësor Rajonal më datë 18.05.1983 i cili në atë kohë quhej Drejtoria e Higjienës dhe Epidemive. Për të gjithë periudhën nga kjo datë deri më 12.04.2012 kishte punuar pa ndërprerje pranë këtij institucioni. Më datë 30.12.2011 nga ana e institucionit i është komunikuar një njoftim për suprimimin e vendit të punës dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës me efekt pas tre muajsh. Pas këtij njoftimi klientja kishte vazhduar punën deri në datën 10.04.2012, datë në të cilën institucioni kishte nxjerrë një urdhër për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare. Arsyeja që

përdorte pala e paditur për ndërprerjen e marrëdhënies së punës ishte Suprimim i vendit të punës. Kjo arsye sipas klientes, përbënte një shkak të paqenë dhe përbënte një mbulim të veprimeve arbitrare të punëdhënësit. Klientja kishte punuar pranë institucionit si sanitare për rreth 29 vjet dhe gjatë kryerjes së punës kishte qenë korrekte duke zbatuar me përpikmëri rregulloren e institucionit dhe urdhërimet e punëdhënësit në lidhje me kryerjen e detyrave. Klientja I.L. kishte qenë një nga punonjëset më të vjetra dhe i duheshin më pak se dy vjet për të dalë në pension pleqërie për shkak të moshës.

Në rastet e suprimimit të vendit të punës nga ana e punëdhënësit duhet të respektohen disa parime lidhur me vjetërsinë në punë apo faktin që punëmarrësi është shumë afër moshës së pensionit, në mënyrë që pasojat në lidhje me veprimet e kryera nga punëdhënësi të jenë me efekte sa më të lehta për punëmarrësin. Largimi nga puna, duke i dhënë fund një marrëdhënie juridike të punës duhet të respektojë pari-

met themelore që garantojnë të drejtat e punëmarrësve sipas legjislacionit të marrëdhënieve të punës.

Në thelb të këtij parimi qëndron "e drejta e mbrojtjes nga veprimet e padrejta të punëdhënësit". Për të garantuar këtë të drejtë, punëdhënësi ka detyrim që, para se të ndërmarë veprime për ndryshimin e marrëdhënies së punës, përfshirë edhe "largimin nga detyra", si veprimi me pasojat më të rëndësishme në marrëdhëniet e punës, të dëgjojë punëmarrësin të shprehë opinionin e tij për veprimet që do të kryhen me kontratën e tij të punës.





Ky parim i rëndësishëm kushtetues (proces i rregullt ligjor - neni 42 "1" i Kushtetutës së R. së Shqipërisë") gjen zbërthimin e vet në nenin 144 të Kodit të Punës.

Sipas Nenit 144 të Kodit të Punës "Pas kohës së marrjes në provë, kur punëdhënësi mendon të zgjidhë kontratën e punës, ai duhet të njoftojë me shkrim punëmarrësin të paktën 72 orë para takimit dhe të bisedojë me të. Punëdhënësi, i parashtron punëmarrësit arsyet e vendimit të marrë për zgjidhjen e kontratës. Zgjidhja njoftohet të paktën pas 48 orëve të bisedës. Ajo duhet të bëhet me shkrim. Punëdhënësi i klientes I.L. nuk

kishte respektuar asnjë nga afatet e mësipërme dhe kishte shkelur dispozitat e parashikuara nga neni 144 i Kodit të Punës.

Në rastin konkret një veprim i tillë nuk ishte kryer nga ana e punëdhënësit dhe kjo përbën mosrespektim të procedurës së ndërprerjes së kontratës së punës nga ana e punëdhënësit në kuptim të përcaktimeve që bën Kodi i Punës në lidhje me këtë procedurë.

Kjo mënyrë jo vetëm që nuk respekton të drejtat e punëmarrësit por nuk respekton as detyrimet që ka një insitucion për të kryer këto veprime procedurale dhe të dëgjojë punëmarrësin në rastin e një zgjidhje të njëanshme të marrëdhënies së punës.

Sipas nenit 146 të Kodit të Punës, Zgjidhja e kontratës nga punëdhënësi, konsiderohet pa shkaqe të arsyeshme kur:

- a. punëmarrësi ka pretendime që rrjedhin nga kontrata e punës;
- b. punëmarrësi ka përmbushur një detyrim ligjor;
- c. bëhet për motive të pandashme nga personaliteti i punëmarrësit,

por që nuk kanë lidhje legjitime me raportet e punës. Konsiderohen si motive të tilla raca, ngjyra, seksi, moshë, gjendja civile, detyrimet familjare, shtatzënia, besimi fetar, bindjet politike, kombësia, gjendja shoqërore;

Zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme është e pavlefshme. Punëdhënësi që ka zgjidhur kontratën pa shkaqe të arsyeshme, detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim deri në një vit pagë, që i shtohet pagës që ai duhet të marrë gjatë afatit të njoftimit.

Shkaqet për të cilat klientja e konsideronte zgjidhjen e marrëdhënieve të punës të paligjshme dhe që u përfshinë në hartimin e kërkesëpadisë ishin:

a) Suprimimi i vendit të punës i paraqitur në mënyrë të tillë dhe duke u zbatuar mbi punonjësit pa asnjë karakter selektiv përbën një arsye për ta konsideruar zgjidhjen e marrëdhënieve të punës pa shkaqe të arsyeshme.

b) Puna rreth 29 vjet pa ndërprerje pranë punëdhënësit si sani-

tare dhe gjatë gjithë viteve të punës fakti i përkushtimit, dhe në ushtrimin e detyrave duke treguar përgjegjshmëri, besnikëri dhe ndershmëri. Këtë fakt e vërteton edhe kohëzgjatja e punës pranë punëdhënësit, jo e vogël prej rreth 29 vitesh.

c) Duke u nisur edhe nga moshë që kishte klientja, i duheshin edhe dy vite për të mbushur moshën për të dalë në pension dhe në një moshë dhe periudhë të tillë është pothuajse e pamundur gjetja e një mënyre tjetër punësimi.

d) Nga ana e punëdhënësit nuk ishte zbatuar asnjë kriter selek-





tiv lidhur me faktin e moshës së klientes I.L. në raport me punonjëset e tjera dhe fakti që kishte punuar për një periudhë prej 29 vjetësh duke mos marrë fare parasysh mundësinë e ndonjë lëvizje të mundshme edhe në ndonjë vend çfarëdo në mënyrë që të mund të arrinte moshën e pensionit.

e) Por ajo që vlen të theksohet dhe që u vu në dukje edhe në kërkesë padinë e paraqitur në Gjykatë ishte fakti që klientja I.L. i përkiste komunitetit egjiptian dhe si e tillë ishte konsideruar nga ana e punëdhënësit si shtresë vul-

nerabël dhe në pamundësi për të reaguar ndaj veprimeve arbitrare dhe si e tillë në raport me personat e tjerë që punojnë pranë këtij institucioni në të njëjtin pozicion pune, ishte "preferuar" për të mos qenë pjesë e institucionit për arsye të komunitetit dhe racës së cilës i përkiste.

Po ashtu Neni 152 i Kodit të Punës parashikon që "Në përfundim të marrëdhënieve të punës që kanë zgjatur jo më pak se tre vjet, punëmarrësi përfiton shpërblim për vjetërsinë si në rastin e zgjidhjes së kontratës me afat të pacaktuar nga punëdhënësi.

Nëse kontrata zgjidhet pa shkaqe të arsyeshme, punëmarrësi ka të drejtë të ngrejë padi kundër punëdhënësit në gjykatë, brenda 180 ditëve nga dita e përfundimit të afatit të njoftimit.

U procedua për mbledhjen e të gjithë dokumentave të nevojshëm që do të shërbenin në këtë rast duke u marrë të gjithë dokumentat. Kjo u bë e mundur nëpërmjet dërgimit të një shkrese zyrtare ndaj institucionit ku ju kërkuan një

kopje dokumentave që ndodheshin në dosjen e klientes pranë punëdhësit, pasi në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punë, këto dokumenta nuk i ishin vendosur në dispozicion asaj. U bë e mundur po ashtu tërheqja e Librezës së Punës nga Zyra e Punës ku ajo ishte depozituar për të bërë të mundur përfitimin e asistencës sociale nga ana e klientes.

Pasi u mbledhën këto dokumenta u përplua kërkesa për në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe u paraqit kërkesa në gjykatë.

Adnan Hoxha
Avokat, TLAS

DËMI JO PASUROR, SHKAKTIMI DHE SHPËRBLIMI I TIJ

**Dëmi jopasuror mund të
përkufizohet si:**

“Një humbje ose pakësim në sferën fizike, mendore, morale, në kënaqësi në jetë, në marrëdhëniet shoqërore, në jetën seksuale etj, e shpërblyeshme nga Kodi Civil, që vjen si pasojë e dëmtimeve në shëndet apo në personalitet e dinjitet qoftë kur pretendohet për vete qoftë kur e pretendon për të afërimit të gjallë apo të vdekur”.



Çdo person në jetën e përditshme mund të kryejë veprime apo mosveprime të cilat mund të sjellin pasoja për të tjerët. Pasojat që të përbëjnë dëm jashtëkontraktor dhe rrjedhimisht përgjegjësi në e shkaktuesit për dëm duhet të përmbushin kushtet ligjore të parashikuara në Kodin Civil në nenet 608 e tutje.

Neni 608 i Kodit Civil të RSH parashikon:

-Personi që në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cënimit dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.

Neni 609

- Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtëpërdrejtë dhe i menjëhershëm

i veprimit ose mosveprimit të personit.

Mospengimi i një ngjarje nga personi që ka detyrimin ligjor për ta mënjanuar, e ngarkon atë me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar."

Që të kemi përgjegjësi për dëmin jopasuror duhet të përmbushen domosdoshmërisht në mënyrë kumulative kushtet e përgjithëshme që parashikojnë dispozitat e mësipërme. Mungesa qoftë e njërit nga këto kushte përjashton personin nga përgjegjësia për veprimin apo mosveprimin e kryer. Këto kushte mund ti ndajmë në kushte objektive: fakti, dëmi i paligjshëm dhe lidhja shkasore dhe në kushte subjektive: faji.

Me veprime mund të konsiderojmë rastet kur në mënyrë aktive dëmtuesi mund të sjell pasoja në shëndetin e një tjetri (gjatë rrugës së tij me shpejtësi drejtuesi i makinës aksidenton një kalimtar që po kalonte rrugën konform rregullave të qarkullimit rrugor), apo në nderin e tij (një gazetar publikon një intervistë të bërë me një artist duke shtuar gjatë kësaj interviste

dhe fakte të paqëna apo pathëna nga i intervistuari duke prishur reputacionin e tij para publikut) etj.

Me mosveprime (ashtu siç e parashikon edhe paragrafi i dytë i Nenit 609) dëmtuesi mund të shkaktoj dëm në rast se ai ka pasur detyrim ligjor për ta shmangur apo mënjeluar një ngjarje dhe përkundrazi nuk ka vepruar për ta penguar atë por ka lënë atë që të ndodh e si pasojë i ka sjellë të dëmtuarit çënim në të drejta dhe interesa që mbrohen me ligj apo nga zakonet e mira.

Çfarë mund të konsiderohet dëm në person?

Dëm jopasuror në person do të konsiderohet në mënyrë përjashtuese çdo gjë që nuk çënon apo dëmton pasurinë e personit por lidhet me atë çfarë nuk është materiale, nuk është pasurore.

Pra kemi dëm në person kur personit i janë pakësuar apo janë mohuar të drejta të tilla si jeta, shëndeti, jeta private, liria personale, banesa, korrespondenca dhe të gjithë të drejtat dhe inte-

resat e personit etj, që mbrohen nga çdo ligj (si ai penal, civil, administrativ) apo akt juridik që dalin në zbatim të tyre, konventë që ka forcë detyruese në shtetin shqiptar si KEDNJ etj.

Ndërsa në ligjin numër 8510 datë 15.07.1999 - Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore" në nenin 12 të saj parashikohet dëmi jopasuror si – "një dëm që ka të bëjë me një çënim të paprekshmërisë trupore, të shëndetit, të lirisë ose të personalitetit..."

Faji është elementi tjetër i domosdoshëm në përgjegjësinë jashtëkontraktore (si dhe në dëmin jopasuror). Ai është element subjektiv i kësaj përgjegjësie dhe lidhet ngushtësisht me vetë personin, shkaktuesin e dëmit. Faji mund të përkufizohet si një qëndrim psikik i personit ndaj veprës së tij dhe pasojave që vijnë prej saj. Legjislacioni civil nuk jep përkufizim të fajit dhe të formave të tij megjithatë mund ti referohemi pa hezituar përcaktimit që i ka bërë e drejta penale fajit dhe formave të tij. Format e fajit janë dy: dashja

me të cilin personi parashikon dhe dëshiron që të vijë pasoja si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të tij (dashje e drejtëpërdrejtë) ose edhe nëse nuk e dëshiron këto pasoja me ndërgjegjie nuk merr masa për ta penguar ardhjen e pasojës por lejojnë të vijnë (dashje e tërthortë).

Faji mund të na shfaqët edhe në formën e pakujdesisë pra kur dëmuesi nuk i parashikon pasojat por që ishte i detyruar ti parashikonte nga situata (neglizhenca) ose parashikon që nga veprimet e tij mund të vijë ndonjë pasojë megjithëse nuk e dëshiron shpreson se me aftësitë e tij mund ti shmangë duke e vlerësuar me mendjelehtësi situatën.

Lidhja shkakësore është një kusht tjetër i domosdoshëm për të ekzistuar dëmi jopasuror. Sipas këtij, pasoja (dëmi) të vijë vetëm si rrjedhojë e shkakut (veprimit apo mosveprimit të dëmtuesit), mënjëherë dhe drejtëpërdrejtë. Pra në mënyrë figurative në zinxhirin që lidh faktin e paligjshëm dhe dëmin të mos ketë asnjë hallkë të këputur.

Kur mund të pretendohet dëmi jo pasuror?

Në nenin 625 të Kodit Civil parashikohet se : *"Personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur: a) Ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cënuar në nderin e personalitetit të tij ; b) Është fyer kujtimi i një të vdekuri dhe kërkohet nga bashkëshorti me të cilin ka bashkëjetuar deri në ditën e vdekjes ose nga të afërmit e tij deri në shkallën e dytë, përveç kur fyerja është kryer kur i vdekuri ka qenë gjallë dhe i është njohur e drejta e shpërblimit të dëmit për fyren e bërë.*

E drejta e parashikuar në paragrafin e mësipërm' është e pa-trashëgueshme."

Dëmtimi në shëndet i jep të drejtë për shpërblim logjikisht çdo personi fizik që ka pësuar një nga dëmet (që do i sqarojmë më poshtë) që nuk ka ndikuar në sferën pasurore të tij.

Ndërsa dëmtimi apo cënimi i nderit dhe personalitetit i jep të drejtë normalisht të pretendoj

për një dëm jopasuror të pësuar si personit fizik ashtu edhe personit juridik.

Dëmi biologjik për shkak të dëmtimit në shëndet.

Bazuar në interpretimin që ka dhënë Gjykata e Lartë në vendimin e saj Unifikues nr. 12 datë 14.09.2007, dëmtimi i shëndetit (dëmi biologjik) përbën, në thelb, cënimin e së mirës së shëndetit, të integritetit fizik dhe/ose psikik të njeriut. Ky dëm jopasuror, i parashikuar nga shkronja "a" e nenit 625 të Kodit Civil, është objekt kërkimi dhe dëmshpërblimi i pavarur nga dëme të tjera pasurore e jopasurore të pësura nga i dëmtuari për shkak të të njëjtit fakt të paligjshëm.

Meqënëse jeta dhe shëndeti i njeriut nuk ka çmim, në respektim të parimit themeltar kushtetues të barazisë përpara ligjit dhe ndalimit të diskriminimit sipas nenit 18 të Kushtetutes, gjykata duhet të garantojë një gjykim uniform dhe vlerësim të njëjtë të përqindjes e të masës së dëmshpërblimit të dëmit

biologjik, për çdo formë e shkallë konkrete të cënimit të përherëshëm a të përkohshëm të integritetit fizik ose psikik të të dëmtuarit, nëse moshja është e njëjtë dhe po i njëjtë është edhe lloji i dëmtimit shëndetsor fizik a psikik të pësuar. Dëmshpërblimi për dëmtimin e shëndetit sipas nenit 625/a të K.Civil kërkohet në mënyrë të pavarur nga kërkimi për dëmin pasuror të humbjes ose pakësimit të aftësisë për punë, i parashikuar në nenin 641 të K.Civil. Sipas kësaj dispozite, interesi pasuror i cënuar përkohësisht apo përgjithmonë si rrjedhojë e dëmtimit të shëndetit nga fakti i paligjshëm, është e drejta e njeriut, e parashikuar në nenin 49 të Kushtetutës, për të fituar mjetet e jetesës, pra edhe për të garantuar e shtuar pasurinë, nëpërmjet punës së ligjshme të zgjedhur me vullnetin e lirë të tij. Njëkohësisht përbën interes të ligjshëm të cënuar edhe pakësimi i pasurisë së të dëmtuarit në formën e shpenzimeve që ai përballon për përkujdesje dhe, në veçanti, për mjekimin e shëndetit të cënuar si rrjedhojë e pandërprerë e të njëjtit fakt të paligjshëm.

Dëmi psikik.

Si pasojë e dëmtimit në shëndet mund të vijë dëmi jopasuror në formën e dëmit psikik e cila konsiston në dëmtime të shëndetit apo integritetit psikik, mendor të të dëmtuarit.

Dëmi psikik është një dëm që e pengon ose e ndalon individin të përjetoj kënaqësitë e të mirave të jetës, të ushtrimit të aftësive të të qenit i arsyeshëm etj duke shkak-tuar një fatkeqësi për viktimën pasi del jashtë arsyes.

Dëmi në sferën afektive

Dëmi në sferën afektive është dëmi në formën e vuajtjes, dhimbjes që pëson një person nga vdekja ose në dëmin në shëndet që pëson një njeri i afërt i familjes.

Dëmi estetik

Si pasojë e dëmtimit në shëndet na paraqitet edhe dëmi estetik apo në shëndetin sipërfaqësor, të jashtëm siç do preferojmë ta quajmë. Dëmi estetik si dëm në shëndet (pasi sjell pasoja në anën

fizike të personit, e vlerësuar edhe nga kontrolli mjeko-ligjor.) mund të shfaqet tek i dëmtuari në formën e një gjymtimi, çikatriçe, vrajë në fytyrë apo një shëmtim.

Dëmi estetik është dëmi që pëson i dëmtuari për shkak të veprimeve apo mosveprimeve të paligjshme në formën e një vrajë në fytyrë, asimetrie në pjesët e fytyrës apo një gjymtimi apo cdo dëmi tjetër në aspektin fizik.

Dëmi estetik sjell dëme të karakterit pasuror {p.sh në rastet kur ky dëm i pësuar në paraqitjen fizike mohon ose të zvogëlon mundësinë për të fituar të ardhura apo për të gjetur punë apo shance të tjera punësimi. Kjo është shumë e dukshme sidomos tek seksi femër ku paraqitja e jashtme ndikon shumë në profesione të tilla si: modele apo fotomodele, aktorë kinemaje apo teatro, stjuardesa , shitëse dy-qanesh dhe cdo profesion tjetër që ka të bëjë me kontaktet me publikun.

Gjykata do e marrë parasysh në shpërblimin e dëmit nëse profesioni i të dëmtuarit lidhej ngushtësisht me paraqitjen e tij të jashtme apo jo. Ndryshe e vuan dëmin estetik

një aktore dhe ndryshe një shtëpiake.

Dëmi në jetën seksuale

Dëmi në jetën seksuale mund të jetë pasojë e dëmtimit në shëndetin (integritetin) e organeve riprodhuese, në mundësinë e zhvillimit të tyre apo mohimin e provimit të kënaqësisë seksuale.

Dëmi në të drejtën për të lindur

Pasojë tjetër që mund të sjellë dëmi në sferën seksuale përveç pamundësisë për të patur marrëdhënie seksuale është edhe pamundësia për të lindur fëmijë.

Dëmi në sferën shoqërore

Dëmi mbi sferën shoqërore haset atëherë kur fakti i paligjshëm dëmton personin në sferën e marrëdhënieve shoqërore, duke mos marrë pjesë në aktivitete kulturore, krijuese, sportive, aktivitete politike, sindikale etj që ai kryente më para jashtë orarit të punës (në kohën e lirë).

Pra dëmi në sferën shoqërore konsiderohet:

a) si një dëm që për shkak të një dëmi në integritetin psiko- fizik mund të sjell si pasojë humbjen e raporteve shoqërore që e karakterizojnë jetën e çdo personi normal.

b) dëmi në jetën shoqërore shfaqet edhe në rastin kur dëmi prek nderin apo reputacionin e personit.

Dëmi Moral

Dëmi moral është shfaqje e brendshme, e përkohshme, e turbullimit të padrejtë të gjëndjes shpirtërore të njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi e mundimi shpirtëror që rrjedh si pasojë e faktit të paligjshëm. Cilido që pëson cenime në sferën e shëndetit dhe të personalitetit të tij nga veprimet a mosveprimet e paligjshme dhe me faj të një të treti ka të drejtën të kërkojë edhe dëmshpërblimin e dëmit moral të pësuar. Kjo e drejtë, në cilësinë e të dëmtuarit, i përket individualisht edhe secilit prej familjarëve

të afërt të personit që ka humbur jetën apo është cënuar në shëndetin e tij nga fakti i paligjshëm, nëse vërtetohet lidhja e tyre e posaçme familjare, ndjesore dhe e bashkëjetesës. Dëmi moral i pësuar nga vetë të afërmit konsiderohet si pasojë, rrjedhim i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë i të njëjtit fakt të paligjshëm.

Pra dëmin moral si dëm jopasuror duhet ta dallojmë nga dëmi biologjik që është lloj tjetër i dëmit jopasuror.

Së *pari* dëmi moral është i përkohshëm, vuajtje shpirtërore, turbullim psikik, ankth jo i vazhdueshëm ndryshe do të përbënte një patologji psikike, dëm psikik që ' mjekohet si "sëmundje.

Së *dyti* dëmi moral nuk cënon integritetin psiko-fizik të individit që vlerësohet nga kontrolli mjeko-ligjor por thjesht individ për shkak të një cënimi në personalitetin apo nderin e tij mund të pësojë një turbullim shpirtëror apo një ankth.

Dëmi moral në të shumtën e rasteve pretendohet si dëm jopasur-

or që përfshijnë personat fizik në rastet e cënimit të nderit apo personalitetit të tyre nga çdo veprim apo mosveprim i paligjshëm.

Kur një personi i ulet reputacioni dhe vlerësimi që ka shoqëria për të, nga fakti i paligjshëm që mund të sjell përgjegjësi civile ose më tej penale s'ka se si të mos ndiejë një turbullim psikologjik, apo vuajtje shpirtërore në formën e një dëmi moral.

Dëmi ekzistencial

Dëmi ekzistencial i shkaktuar nga fakti i paligjshëm i të tretit cënon të drejtat e personalitetit të njeriut duke dëmtuar thuajse në menyrë të përhershme shprehjen dhe realizimin e të dëmtuarit si njeri, shfaqjen e personalitetit të tij në botën e jashtme, duke tronditur objektivist jetën e përditshme dhe veprimtaritë e zakonshme të tij, duke i shkaktuar përkeqesim të cilësisë së jetës nga ndryshimi dhe prishja e ekuilibrit, sjelljes e zakoneve të jetës, të marrëdhënieve personale e familjare. Për shkak të një gjendjeje të tillë psiko-fizike, i dëmtuari nuk mund të kryejë më

veprimtari të caktuara që karakterizonin pozitivisht qënien e tij apo mund t'a karakterizonin pozitivisht në të ardhmen, duke e detyruar të shtyhet drejt zgjidhjeve të ndryshme në jetë nga ato të dëshiruara e të pritshme apo në heqjen dorë nga keto të fundit për shkak të vërtetimit të faktit të paligjshëm. Dëmi ekzistencial, duke mos patur natyrë thjesht ndjesore e të brendshme, është objektivisht i vërtetueshëm.

Perveç të tjerave, dëmi ekzistencial cënon të demtuarin në marrëdhëniet dhe interesat e jetës familjare, sociale, kulturore, sportive, të veprimtarisë zbavitëse, argëtimit, të shlodhjes, etj., të cilat çdo individ ka të drejtë t'i gezojë dhe që ndikojnë në mënyra e shkallë të ndryshme, në varësi të ndjeshmerisë dhe formimit të personalitetit të gjithësecilit, në sferën psikike të të demtuarit, duke bërë që të alterohen në një masë të prekshme në kuptimin negativ, duke u shfaqur në botën e jashtme, vetë marrëdhëniet e tij familjare, sociale, kulturore, afektive, etj.

Dëmi ekzistencial, si shfaqje e jashtme e cënimit të interesave të ligjshme lidhur me cilësinë e jetës, ndryshe nga ai moral, është objektivisht i vërtetueshëm dhe nuk mund të provohet vetëm me anë të prezumimeve të thjeshta. Gjykata duhet të pranojë vetëm ato cënime, konkrete, të të drejtave të personalitetit për të cilat ka bërë kërkim dhe që pretendohen nga i demtuari si dëm ekzistencial i pësuar prej tij. Duke qënë cënime me natyrë subjektive dhe të lidhura ngushtë me personin e të demtuarit, ai ka barrën e provës të vërtetojë me prova pozitive alterimin në kuptimin përkeqsues të ekuilibrit, të zakoneve të jetës dhe vetë ekzistencës së tij personale për shkak të faktit të paligjshëm.

Për caktimin e dëmshperblimit të dëmit ekzistencial, gjykata çmon mbi rrethana që vërtetojnë ndryshim të dukshëm e të rëndësishëm përkeqësues të jetës së përditshme dhe impaktin aktual e të ardhshëm të këtyre ndryshimeve në interesat jopasurore dhe marrëdhëniet e të demtuarit me botën e jashtme. Në veçanti, në rastet

e vdekjes apo dëmtimit të rëndë të shëndetit të të afërmit, për caktimin e masës së dëmshpërblimit ekzistencial mbahen parasysh edhe afërsia gjinore, moshë e viktimës dhe e të dëmtuarit, përberja dhe gjendja e bashkëjetesës në familje, si dhe rrethana të tjera që provojnë përkeqsimin e gjendjes deri në pamundësinë e shprehjes së aftësive të të dëmtuarit për të zhvilluar interesat dhe veprimtari në e përditshme.

Sikurse ai moral, edhe dëmi ekzistencial ka natyrë subjektive. Prandaj, shumica e dëmshpërblimit të tij caktohet në mënyrë të pavarur nga dëmi moral, por duke zbatuar të njëjtat kritere dhe metoda të vlefshme për llogaritjen e dëmshpërblimit të këtij të fundit.

Mënyrat e shpërblimit të dëmit jopasuror

Bazuar në nenin 643, në paragrafin e fundit të tij parashikohet: *“Gjykata duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, mund të vendosë që shpërblimi të jepet në natyrë ose në para, njëherësh ose me këste.”*

Pra, mund të themi që gjykata në dispozitiv shprehet për lloje të ndryshme shpërblimesh të dëmit si:

- a) shpërblimi në të holla, në para;
- b) shpërblimi në natyrë;
- c) me kërkesën edhe të paditësit mund të vendosë në dispozitiv që i padituri të shpërblejë dëmin në të dy mënyrat e mësipërme.

Shpërblimi në të holla, ndahet në:

- a) shpërblim i plotë i dëmit dhe b) në shpërblim simbolik i dëmit ose nominal.

- *Shpërblimi i plotë* i dëmit jepet në bazë të parimit kryesor që ekziston në teorinë mbi shpërblimin e dëmit. Në përgjithësi, çdo dëm që i shkaktohet një personi, pasuror apo jo, duhet të synojë që ta kthejë të dëmtuarin në gjendjen e mëparshme, pra njësoj sikur dëmi të mos kishte ekzistuar fare. Ky parim gjen zbatim të saktë te dëmi pasuror, i cili me veprimet matematikore kthen personin në gjëndjen që ai kishte më përpara, sipas nenit 640 të Kodit civil¹⁰. Shpërblimi jopasuror i plotë synon

një kompensim të gjendjes së të dëmtuarit, por kurrësi një përmirësim të anës ekonomike të tij, apo një pasurim të të dëmtuarit, sepse do të çonte në humbjen e funksionit të shpërblimit dhe do të sillte tregtimin e të mirave njerëzore. Kjo bëhet akoma më e papranueshme kur bëhet fjalë për vlera të personalitetit të njeriut si nderi, dinjiteti, etj. "Karakter i plotë i shpërblimit ka të bëjë me gjithë dëmin dhe asgjë më shumë se sa dëmi."

- *Shpërblimi simbolik* apo shpërblimi nominal paraqitet si një lloj i shpërblimit në të holla. Quhet i tillë për shkak të shumës tepër të vogël që jepet nga gjykata me kërkesë të të dëmtuarit, pra ky shpërblim ka një përmbajtje ekonomike "boshe" që nuk i korrespondon një dëmi me vlerë ekonomike. Shpërblimi i dëmit në natyrë ose shpërblimet specifike. Përveç shpërblimit të dëmit në të holla njihet edhe shpërblimi në natyrë, i quajtur kështu pasi realizohet në të njëjtën mënyrë dhe formë siç u krye dëmi ose shpërblimi specifik, siç njihet në doktrinën

italiane. Si lloje të shpërblimeve në natyrë apo specifike konsiderohen:

- Shkatërrimi i mjeteve që kanë kryer dëmin e paligjshëm; Gjykata, sidomos për dëme që çenojnë personalitetin apo nderin e personit, mund të vendos shkatërrimin e materialeve (letrat apo filmat etj.), me anë të të cilës është realizuar p.sh. shpifja apo fyerja etj.

- Përgënjeshtrimi i shprehjeve fyese; Në mjetet e masmedias jepet si një shpërblim që dallon nga shpërblimi në para dhe është karakteristike për dëmet morale që vijnë nga cënimi i nderit dhe personalitetit.

Kriteret që merren parasysh nga gjykata për shpërblimet mbi dëmin jopasuror.

E gjithë procedura e gjykimit të padisë mbi dëmin jopasuror finalizohet në një vendim përfundimtar të gjykatës, në një shumë në të holla ose/dhe ndonjë formë e veçantë shpërblimi (përgënjeshttrim apo publikim vendimi). Të llogarisësh cënimin në nder, në dinjitet apo dëmtime në shëndet

të përsosur duhet mbajtur parasysh nga gjykata se nuk është njësoj si llogaritjet matematikore të dëmit pasuror, pavarësisht se në fund dilët me një shifër konkrete. Në këto çështje delikate kërkohet një përkushtim serioz nga të gjithë pjesëmarrësit në proces.

a) Rrezikshmëria e faktit.

Rrezikshmëria e faktit dhe masa e shpërblimit qëndrojnë në raport të drejtë me njëra-tjetrën, sa më i rëndë të jetë fakti civil aq më i madh do të jetë edhe shpërblimi. I njëjti kriter, për analogji, merret parasysh edhe nga gjykata penale në caktimin e dënimit, sa më e rrezikshme është vepra penale, aq më e rëndë është edhe masa e dënimit, e caktuar nga legjislatori e nga gjykata.

b) Forma e fajit

Pavarësisht se bëhet një diferencë mes fajit në të drejtën penale dhe në atë civile përsëri gjykata do të marrë parasysh si kriter vlerësimi nëse kryerja e veprimit të paligjshëm është e qëllimshme jo,

në neglizhencë apo në vetëbesim të tepruar. Nëse gjatë kryerjes së faktit të paligjshëm ose pas saj i dëmtuari apo dëmtuesi kanë vepruar me pakujdesi të lehtë apo të rëndë etj.

c) Rëndësia e vuajtjes shpirtërore

Humbja a cënimi që i dëmtuari pëson në shëndet, në sferën seksuale, reputacion, në kënaqësitë e jetës mund të jetë e ndryshme për persona të ndryshëm, megjithëse kanë pësuar të njëjtin dëm. Pra, do të merret parasysh tipi i personit, nëse është tepër i ndjeshëm, melankolik, një fyerje qoftë edhe e parëndësishme për një person “mesatar” do të konsiderohet për të tepër e rëndë dhe anasjelltas, për një person që është me natyrë moskokëçarëse, menefregiste etj.

ç) Kushtet ekonomike të të dëmtuarit dhe dëmtuesit

Në përcaktimin e shpërblimit përfundimtar do të merren parasysh, kushtet ekonomike, gjendja shoqërore e të dëmtuarit ashtu edhe të dëmtuesit. Në rastin e

një dëmi jopasuror shpërblimi nuk vlen që të sjellë te viktimat një pasuri, por mbi të gjitha kjo shërben për t'i dhënë mundësinë për të realizuar veprimtari zëvendësuese për të lehtësuar dhembjen apo të kryejë ato veprime që do t'i realizonte nëse nuk do ishte kryer dëmi. A mund të jepet i njëjti shpërblimi (me funksion sadsifaksues) një personi të integruar në shoqëri, të ardhurat e të cilit i japin mundësi që të ndjekë veprimtari të shumta zëvendësuese dhe një person që me të ardhurat që ka nuk do të arinte kurrë veprimtari të tilla sadsifaksuese a qetësuese të dhembjes si p.sh., udhëtime apo dëfrime?

Po ashtu është shumë e rëndësishme edhe gjendja ekonomike e dëmtuesit, sepse një masë shpërblimi tepër e lartë kur gjendja ekonomike e dëmtuesit është tepër e vështirë do të sillte një shpërblim të parealizueshëm dhe shumë e vështirë për t'u ekzekutuar, gjë që nuk është në qëllimet as të vetë palës së dëmtuar.

d) Përfitimet e marra nga dëmtuesi.

Në momentin kur shkaktohet dëmi jopasuror, pala që shkakton dëmin në një farë mënyre kërkon të realizojë edhe një përfitim, p.sh. redaksia e një gazete nëpërmjet një shpifjeje që mund të bëhet ndaj një personazhi të njohur mund të ketë rritje të blerjes, si rrjedhim edhe një fitim më të madh. Në këtë rast, gjykata do të marrë parasysh, se cilat janë përfitimet ekonomike (duke përcaktuar një shifër konkrete që ka fituar dëmtuesi atë ditë dhe që i atribuohen lajmit). Masën e këtyre përfitimeve gjykata mund ta çmojë t'ia japë të dëmtuarit, pasi nga lajmi i rremë ose fyes për të, i padituri (dëmtuesi) ka pasur këtë fitim.

dh) Cilësitë e personit të dëmtuar

Genia e personit të dëmtuar publik apo të famshëm është një faktor që duhet marrë parasysh në caktimin e masës së shpërblimit. Pavarësisht se është pranuar nga doktrina, se personat publikë duhet të jenë më tolerantë ndaj

çdo përpjekjeje të të tjerëve për të ndërhyrë në jetën private, pasi është më normale, e zakonshme, që të jenë "objekt" kritike apo debati. Përsëri kjo nuk e justifikon faktin që atij t'i cënohen vlerat morale apo dinjiteti si individ. Kjo kategori ka të drejtë të mbrojë këto vlera si çdo person tjetër.

e) Mënyra e shkaktimit të dëmit apo mjetit të përdorur

Mjeti i përdorur ndikon në shpërblimin e dëmit, sidomos kur kemi të bëjmë me dëmet mbi personalitetin dhe nderin. Në këtë rast sa më publik të jetë ambienti, rrugë, bulevard etj, apo sa më i përhapur të jetë mjeti i përdorur, si për shembull televizioni, radioja apo shtypi etj., aq më i madh është shpërblimi që do të jepet. Ndryshe do të vlerësohet një fyerje e bërë në një ambient para dy tre vetave dhe ndryshe kur ajo bëhet nga një gazetë me tirazh 20 000 kopje në ditë.

f) Pasojat ekonomike dhe pasoja të tjera
Në shpërblimin e dëmit, gjykata

duhet të marrë parasysh edhe pasojat ekonomike që i ka sjellë personit të dëmtuar, një dëm jopasuror i shkaktuar, p.sh. nëse është fyer në nderin e tij një avokat apo një mjeke, mund të sjellë uljen e klientëve të tyre apo në rast pësimi të një paralize të kryetarit të familjes ulja e të ardhurave, etj. Në fakt, këto mund të qëndrojnë edhe si pretendime më vete, por në rast se pala e dëmtuar nuk ka paraqitur padi për dëm pasuror si pasojë e dëmtimit në shëndet, por vetëm padi për dëm jopasuror, ajo mund të shtojë objektin e padisë para gjykatës që pa përfunduar gjykimi. Përveç dëmeve të drejtpërdrejta dhe të dukshme që vijnë që në fillim nga shkak i paligjshëm shpesh nuk mungojnë edhe pasojat të tjera indirekte që gjithsesi shkaktojnë për të dëmtuarin vuajtje dhe dhembje, p.sh., nga shpifje që është bërë një personi nga një gazetë, bashkëshortja e tij mund t'i kërkojë zgjidhje të martesës, punëdhënësi e pushon nga puna apo në rastin e dëmit estetik vajza skualifikohet nga pjesëmarrja në konkursin e bukurisë etj. Megjithatë, provimi i pa-

sojave të tilla sjell vështirësi për të demtuarin dhe shpesh heqje dorë nga këto pretendime.

g) Mosha, gjinia dhe gjendja shoqërore e të dëmtuarit

Mosha e të dëmtuarit është shumë e rëndësishme, madje në Francë duke u nisur nga ky kriter, juristët e doktrinës kanë krijuar edhe dëmin "juvenil". Ky dëm legjitimon të miturin që të kërkojë shpërblim për pamundësinë për të ushtruar disa profesione etj, për shkak të dëmit psiko-fizik të pësuar kur ai të rritet. Nësë një grua 70 vjeçe dhe një vajzë 20 vjeçe do të pësonin një aksident dhe nga ndërhyrja kirurgjikale mjekët u detyruan t'u heqin uterusin (mitrën) gjykata do të vlerësojë ndryshe dëmin shëndetësor të pësuar për gruan 70 vjeçe dhe ndryshe për vajzën pasi i humbet shpresa për të bërë fëmijë. Gjinia është shumë e rëndësishme për dëme të ndryshme jopasurore, si p.sh. në rastin e një cënimi në nder apo në personalitet apo në një dëm estetik, përsëri femrat janë të predispozuar të vuajnë më shumë humbjen e bu-

kurisë së tyre se sa meshkujt aq më gjykimit të çështjes në arsyetimin e saj, gjykata çmoi se dëmi i paligjshëm ishte shkaktuar në një zyrë ku të pranishëm ishin trupi gjykues dhe palët ndërgjyqëse, prandaj nuk mund të kemi një fyerje të bërë botërisht.

gj) Profesioni

Reputacioni profesional për disa persona dhe për lloje specifike profesionesh ka shumë rëndësi. Çdo dëm që mund të ndikojë në këto raste duhet të kihet parasysh te gjykata në shpërblimin e dëmit, p.sh., ndryshe mund të vlerësohet një fyerje apo shpifje e një politikani nga një shtëpiake ose të një një personi të papunë apo dëmi estetik, çikatriçe a shpërftytyrim i një supermodeleje në krahasim me një rrobaqepëse, pasi imazhi i saj paguhet dhe është burim të ardhurash për të, ajo humbet të vazhduarit të një profesioni të fillë për tërë jetën.

Anisa Metalla
Avokate/Keshilltare Paraligjore,
TLAS

Histori e vërtetë

Rasti i klientit K.K.

Klienti K.K u paraqit pranë Shërbimit Ligjor Falas ku dhe kërkonte të merte këshilla ligjore lidhur me çështjen e tij të pronësisë. Lidhur me këtë problem ky klient u këshillua dhe u orientua lidhur me rrugën ligjore që duhet të ndiqte për zgjidhjen e konfliktit të pronësisë. Klienti u paraqit disa herë në zyrë për këtë problem dhe nga intervistimi u konstatua që klienti K.K gjithashtu ishte invalid për shkak të një aksidenti që kishte pësuar duke punuar. Nga historia

e aksidentit dhe mënyrës se si kish ndodhur u konstatua se:

K.K. punonte si elektrikist privat në lagjen e tij. Në një ditë të zakonshme pune i kishte telefonuar një banor i lagjes së tij ku i kishte kërkuar t'i kryente një shërbim. Ky person ishte pronar i një kabine shtyllore private. Ky person e pajtoi K.K. me qëllim demontimin e kësaj kabine private shtyllore.

Kjo gabine elektrike kishte qënë furnizues i energjisë elektrike për shtëpitë rreth e rrotull, por që sipas fjalëve të punëdhënësit të K.K kjo ishte jashtë funksionit. Këtë atij ja kishin thënë persona të specializuar që punonin në KESH. Gjithashtu punëdhënësi e siguroi që gabina elektrike ishte tentuar të cmontohej dikur dhe në atë kohë ishte provuar që nuk kalonte energji elektrike në këtë gabinë. Nga ana tjetër shtëpitë për rreth nuk furnizoheshin më me këtë gabine pasi në këtë zonë ishte vendosur linja e re që furnizonte lagjen prej 20kV si dhe gabinës elektrike i ishin hequr urat dhe ishin hapur thikat T.M. Duke ditur se KESH në raste të



tilla ka si detyrim shkëptujën e gabinës nga rrjeti elektik shpërndarës, duke qënë se klienti kishte qënë punonjës i KESH por dhe nga rrethanat e tjera në tërësi ai kishte dalë në konkluzionin gabina elektrike duhet të ishte shkëputur nga rrjeti elektik shpërndarës dhe nuk duhet të furnizohej me energji elektrike. Kështuqë ai kishte filluar punën me demontimin e kabinës. Disa kohë pasi kishte filluar punën, duke tentuar të zbërthente njërin prej bullonave të kabinës, klienti kishte rënë në kontakt me tensionin e lartë dhe si pasojë kishte pësuar djegien e rëndë të të dy duarve dhe të barkut.

Nga historia e klientit u konstatua që ai kishte pësuar një dëm në shëndetin e tij si pasojë e të cilit i lindte e drejta e dëmshpërblimit. Nga avokati i TLAS u konstatua së operatori i shpërndarjes së energjisë (në kohën e ngjarjes kompania KESH- shpërndarje) kishte vepruar me faj. Të gjithë rastit ju bë një analizë e thelluar juridike nga ku u konstatua se :

Dëmi

Nga analiza e provave dhe fakteve rezultoi se klienti kishte pësuar një dëm në shëndet.

Gjithashtu nga Aktet e Ekspertimit të përpiluara për këtë rast vërtetohet lidhja shkakësore mes veprimit (kalimi i rymës elektrike të tendionit të lartë) dhe psojës së ardhur në shëndetin e klientit (djegie e duarëve dhe nje pjese të barkut).

Kush ishte shkaktuesi i dëmit, prapsonat përgjegjës për dëmin e shkaktuar?

Bazuar në Rregulloren e Sigurimit dhe Shrytëzimit Teknik të Impjanteve dhe Instalimeve Elektrike



e vitit 2003 , ne pjesën IV të tij për Përgjegjësitë dhe masat administrative në pikën A.1 thuhej: "Përgjegjësi mban edhe Operatori i shpërndarjes për lënie të linjës kabllore nën tension 6kv që furnizon kabinën shtyllore private "Y"...." ...si dhe ne pikën 1-143 ku thuhet :"Në udhëzimin e shfrytëzimit të remontit duhen të jenë treguar qartë:

- a) Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësi e personelit të shfrytëzimit,
- b) Mirëmbajtja e paisjes në kohën e shfrytëzimit normal dhe gjatë avarive,

c) Kontrolli i paisjeve dhe remonti i tyre."

Elementët përbërës të dëmeve të shkaktuara që duhet të shpërbleheshin

Neni 640 K.C përcakton konceptin e dëmit që duhet të shpërblehet. Sipas Ktij neni *"Dëmi pasuror që shpërblehet përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar. Shpërblehen gjithashtu shpenzimet e kryera në mënyrë të arsyeshme për të shmangur ose pakësuar dëmin, ato që kanë qënë të nevojshme për të përcaktuar përgjigjësinë dhe masën e dëmit, si dhe shpenzimet e arsyeshme të kryera për të siguruar shpërblimin në rrugë jashtëgjyqësore."*

Neni 641 K.C ka përcaktuar në mënyrë më specifike dëmet që duhet të shpërblehen në rastet e dëmtimit të shëndetit. Sipas ktij neni *"Personi qe i ka shkaktuar tjetrit një dëm në shëndetin e tij, detyrohet ta shpërblejë dëmin, duke patur parasysh humbjen ose pakësimin e aftësisë për punë të të ëemtuarit, shpenzimet që janë bërë për mjekimin e tij, si dhe*




shpenzime të tjera që kanë lidhje me dëmin e shkaktuar."

Gjithashtu në përcaktimin e dëmit për t'u shpërblyer duhet mbajtur parasysh edhe dëmi jopasuror i parashikuar nga neni 625 i K.C.

Sipas këtij neni pika "a", *Personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur: a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cënuar në nderin e personalitetit të tij:..."*

Përcaktimin e saktë të përmbajtjes së dispozitave të mësipërme të K.Civil e ka analizuar në hollësi Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 12 datë 14.09.2007.

Sipas këtij vendimi në përcaktimin e dëmit duhen mbajtur parasysh, dëmet e shkaktuara (të nevojshme) për mjekimin e paditësit, dëmet e shkaktuara nga humbja e aftësisë së tij për punë, shumat e nevojshme për mjekimin e paditësit, si dhe dëmi jopasuror për paditësin në formën e dëmit moral, ekzistencial dhe dëmit biologjik. Konceptet dhe kriteret e vlerësimit për sejcilin prej këtyre kategorive të dëmit jopasuror janë përcak-



tuar në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 12 datë 14.09.2007. Sipas këtij vendimi të gjykatës:

Dëmi jopasuror, i parashikuar në nenin 625 të Kodit Civil, si një kategori e gjerë dhe gjithëpërfshirëse e dëmeve jashtëkontraktore, përfshin çdo lloj dëmi të pësuar nga cënimi i të drejtave dhe interesave jopasurore që bëjnë pjesë në vlerat e njeriut dhe që nuk janë subjekt vlerësimi të drejtëpërdrejtë ekonomik në treg. Në thelbin e saj, kjo dispozitë njeh të drejtën e dëmshpërblimit për çdo lloj dëmi



jopasuror jashtëkontraktor, i cili është "i ndryshëm nga ai pasuror".

Dëmtimi i shëndetit (dëmi biologjik) përbën, në thelb, cënimin e së mirës së shëndetit, të integritetit fizik dhe/ose psikik të njeriut. Ky dëm jopasuror, i parashikuar nga shkronja "a" e nenit 625 të Kodit Civil, është objekt kërkimi dhe dëmshpërblimi i pavarur nga dëme të tjera pasurore e jopasurore të pësura nga i dëmtuari për shkak të të njëjtit fakt të paligjshëm.

Në rastin e klientit K.K. djegia e durarëve dhe një pjesë të barkut ishte dëmi i drejtpërdrejtë që i kishte ardhur shëndetit të tij nga e cila i

lindte dhe e drejta e dëmshpërblimit.

Dëmshpërblimi për dëmtimin e shëndetit sipas nenit 625/a të K.Civil kërkohet në mënyrë të pavarur nga kërkimi për dëmin pasuror të humbjes ose pakësimit të aftësisë për punë, i parashikuar në nenin 641 të K.Civil. Sipas kësaj dispozite, interesi pasuror i cënuar përkohësisht apo përgjithmonë si rrjedhojë e dëmtimit të shëndetit nga fakti i paligjshëm, është e drejta e njeriut, e parashikuar në nenin 49 të Kushtetutës, për të fituar mjetet e jetesës, pra edhe për të garantuar e shtuar pasurinë, nëpërmjet punës së ligjshme të zgjedhur me vullnetin e lire të tij. Në këtë rast klienti kishte pësuar një dëm gati të pariparueshëm dhe duket ta kishte plotësisht të pamundur kryerjen e punëve në të ardhmen për të garantuar e shtuar pasurinë e saj në kuptim të analizës së mësipërme ligjore. Njëkohësisht përbën interes të ligjshëm të cënuar edhe pakësimi i pasurisë së të dëmtuarit në formën e shpenzimeve që ai përballon për perkujdesje dhe, në veçanti, për mjekimin e shëndetit

të cënua si rrjedhojë e pandërprerë e të njëjtit fakt të paligjshëm. Dëmi i pësuar nga klienti e kishte rënduar tej mase gjëndjen ekonomike të familjes së tij e cila ishte një familje në nevojë dhe me të ardhura të pakta. Pas dëmit të pësuar përveç shpenzimeve të bëra deri në momentin e paraqitjes në zyrën tonë, klienti K.K kërkonte edhe në vazhdim shpenzime të konsiderueshme për mjekime dhe përkujdesje lidhur me gjëndjen e shëndetit të tij.

Dëmi moral (pretium doloris ose pecunia doloris) është shfaqje e brendshme, e përkohshme, e turbullimit të padrejteë (non iure per turbatio) të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore apo gjëndje ankthi e mundimi shpirtëror që rrjedh si pasojë e faktit të paligjshëm. Cilido që pëson çënime në sferën e shëndetit dhe të personalitetit të tij nga veprimet a mosveprimet e paligjshme dhe me faj të një të treti ka të drejtën të kërkojë edhe dëmshpërblimin e dëmit moral të pësuar.



Klienti në këtë rast kishte pësuar një tronditje të thelle psikologjike duke qënë se duart për të ishin jetike jo vetëm për rëndësinë që kanë gjymtyrët në tërësinë e integritetit fizik , por se ishin dhe të rëndësishme për ushtrimin e profesionit të tij dhe sigurimin e të ardhuarve për mbajtjen e familjes.

Dëmi ekzistencial i shkaktuar nga fakti i paligjshëm i të tredit çënon të drejtat e personalitetit të njeriut duke dëmtuar thuhajse në mënyre të përhershme shprehjen dhe realizimin e të dëmtuarit si njeri, shfaqjen e personalitetit të tij në botën e jashtme, duke tronditur

objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtaritë e zakonshme të tij, duke i shkaktuar përkeqsim të cilësisë së jetës nga ndryshimi dhe prishja e ekuilibrit, sjelljes e zakoneve të jetës, të marrëdhënieve personale e familjare. Për shkak të një gjëndjeje të tillë psiko-fizike, i dëmtuari nuk mund të kryejë më veprimtari të caktuara që karakterizonin pozitivisht qënien e tij apo mund t'a karakterizonin pozitivisht në të ardhmen, duke e detyruar të shtyhet drejt zgjidhjeve të ndryshme në jetë nga ato të dëshiruara e të pritshme apo në heqjen dorë nga këto të fundit për shkak të vërtetimit të faktit të paligjshëm Dëmi ekzistencial është lehtësisht dhe objektivisht i vërtetueshëm në këtë rast pasi paditësi nuk mund të kryej normalisht proceset jetësorë ku janë të rëndësishme përdorimi i duarëve dhe nuk mund të marr pjesë normalisht në veprimtaritë profesionale, cka ndikon fuqishëm në shfaqjen e tij të jashtme si njeri, në vlerësimin dhe konsideratën e tij për veten si dhe në plotsimin e detyrimeve të tij për të kontribuar në edukimin dhe mirëritjen e fëmijëve të tij duke qënë së

tashmë nuk mund të ushtrojë profesionin e tij.

Nga kjo analizë ligjore u gjet që klienti mund të legjitimohej për të kërkuar gjyqësisht shpërblimin dhe kompensimin e dëmëve pasurore dhe jo pasurore të ardhura si pasojë e aksidentit të pësuar. Për këtë arsye ai u inkurajua që të ngrinte një pretendim të tillë. Nga avokati i TLAS u hartua kërkesë-padi me të gjitha argumentat e duhur ligjor dhe çështja u paraqit për shqyrtim në gjykatë. U kërkuar gjithashtu që klienti K.K. të përjashtohet nga pagimi i taksës mbi aktet e gjykatës për shkak se ai ishte i valid dhe i papunë, kërkesë kjo e cila u mor parasysht dhe u pranua nga Gjykata.

Aktualisht çështja është në përfundim të gjykimit të saj, ku dhe janë legjitimuar një pjesë e kërtimeve të klientit K.K. dhe gjithashtu është vlerësuar në lek edhe masa e dëmit të pësuar.

Anisa Metalla
Avokate/Keshilltare Paraligjore,
TLAS

STREET LAW TE ZHVILLUAR PER VITIN 2012

Projekti	RRETHET							Nr.total i publikimeve	Nr.total i perfitueseve
	Tirane	Durres	Elbasan	Fier	Shkoder	Korce	Vlore		
UNICEF 2011-2012	25.01.2012 24.02.2012							200 Publikime	300 Perfitues
UNDP	29.02.2012	17.02.2012	02.03.2012 10.05.2012					970 Publikime	1200 Perfitues
CRD	03.05.2012 03.06.2012 26.06.2012		10.04.2012 21.05.2012	10.06.2012 05.07.2012				1610 Publikime	1800 Perfitues
UNICEF 2012-2013			28.06.2012					100 Publikime	200 Perfitues
VAF	14.02.2012 20.02.2012							200 Publikime	300 Perfitues



Foto nga aktivitetet
“Street Law”





SHERBIMI LIGJOR FALAS TIRANE

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)

Rruga "Sami Frashëri"

4 kullat, Seksioni 3, Ap. 1A, Tirana, Albania

Tel/Fax: +355 4 2258 442

Tel: +355 4 2253 114

Kutia Postare 69

E-mail: tlas@tlas.org.al

www.tlas.org.al

TIRANA LEGAL AID SOCIETY

SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË

Nr. 2 / 2012

TLAS

